



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në**

**“ Juridik i Përgjithshëm”**

**“Universiteti Europian i Tiranës”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof.Asoc. Dr.Enkeleda OLLDASHI**

**Prof.Asoc. Dr.Jola BODE**

**Shtator / 2022**



**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT****Bachelor në “Juridiki Përgjithshëm”**

1	IAL aplikues:	Universiteti Europian i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Juridike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “ Juridik i Përgjithshëm”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 636, datë 20.09.2006
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Urdhër Nr. 235, datë 15.07.2020, është bërë riorganizimi nga program i ciklit të parë Bsc në “Juridik i Përgjithshëm” me 180 ECTS, në program i integruar i ciklit të dytë Msc në “Drejtësi” me 300 ECTS
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 380, datë 12.10.2015
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër Nr. 183, datë 19.04.2016
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	7 PAE / 2 PAK
18	Numri i studentëve: *	Viti 2017-2018 156 studentë; Viti 2018-2019 76 studentë; Viti 2019-2020 47 studentë;
19	Komente / të tjera:	Ky akreditim vlen vetëm për studentët që janë aktiv për programin e pa riorganizuar.

\* Nuk ka student të regjistruar mbas vitit akademik 2019-2020, pasi programi është riorganizuar



## **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit Bachelor në “Juridik i Përgjithshëm” është një program i ciklit të parë të studimeve i organizuar në tre vite akademike në jo më pak se 180 ECTS. Ky program studimi është hapur me VKM nr.636, datë 20.09.2006 “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike UET”.

Programi i studimit Bachelor në “Juridik i Përgjithshëm” është akredituar fillimisht me Urdhërin e Ministrisë së Arditimit dhe Shkencës Nr.246, datë 24.07.2009, dhe akreditimi periodik, me Urdhërin nr.183, datë 19.04.2016 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, bazuar në Vendimin e këshillit të Akreditimit Nr.131, datë 18.02.2016. Ky program studimi është riorganizuar bazuar në Urdhërin Nr. 235, datë 15.07.2020 të MASR, nga program studimi i ciklit të parë Bachelor në “Juridik i Përgjithshëm”, me 180 kredite në programin e integruar të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Drejtësi”, që realizohet me 300 kredite dhe kohëzgjatje 5 vite akademike. **Theksojmë që ky akreditim vlen vetëm për studentët që janë aktiv në programin Bachelor në “Juridik i Përgjithshëm”.**

Programi i studimit Bachelor në “Juridik i Përgjithshëm” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Juridike, si njësi bazë përgjegjëse. Departamenti i Shkencave Juridike është një ndër tre njësitë e Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Ky Fakultet përbëhet nga:

- 1. Departamenti i Shkencave Juridike;**
2. Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara;
3. Qendra për Metodologjinë dhe Kërkimin Shkencor;

Programi i studimit Bachelor në “Juridik i Përgjithshëm” është program më kohë të plotë në gjuhën shqipe. Ky program studimi synon të formojë jurist me njohuri të përgjithshme në fushën e jurisprudencës. Studentët që diplomohen në këtë program studimi mund të vijojnë dhe ciklin e dytë të studimeve në Master Shkencor ose në Master Profesional.





## SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Akreditimi i programi i studimit Bachelor në “Juridik i Përgjithshëm” është realizuar me Urdhërin Nr.183, datë 19.04.2016 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, bazuar në Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr.131, datë 18.02.2016, **shoqëruar me rekomandimin:**

*Rekomandohet që Institucioni, edhe pse ka një përmirsim të dukshëm nga akreditimi i parë, të përmirësojë në vijim kualifikimin e stafit të brendshëm akademik që mbulon këtë program studimi, sidomos në fushat specifike të së drejtës.*

Nga të dhënat e depozituar nga institucioni, GVJ konstaton rritje të kualifikimeve të stafit akademik të brendshëm (PAE) në fushat përkatëse të së drejtës: gjatë vitit 2019-2020 - 12 pedagogë mbajnë tituj akademik ose gradë shkencore, ndërsa në vitin akademik 2020-2021 ky numër është reduktuar në 10 pedagogë me tituj akademik ose gradë shkencore dhe në vitin akademik 2021-2022 në 6 pedagogë që mbajnë tituj akademik ose gradën shkencore. Më poshtë janë të përfshira dhe të dhënat e mësipërme:

Për vitin akademik **2019-2020** janë të angazhuar 25 pedagogë gjithsej, ndër të cilët **19 PAE** nga ku **3 me titullin “Prof.Dr.”**, **2 me titullin “Prof.Asoc.”**, **7 me gradën “Dr”** dhe 7 lektorë me Msc dhe 6 PAK nga ku 1 me titullin “Prof.Dr.”, 2 me gradën “Dr” dhe 3 lektorë me Msc; Për vitin akademik **2020-2021** janë të angazhuar 18 pedagogë gjithsej, ndër të cilët **16 PAE** nga ku **1 me titullin “Prof.Dr.”**, **1 me titullin “Prof.Asoc.”**, **8 me gradën “Dr”** dhe 6 lektorë me Msc dhe 2 PAK nga ku 1 me titullin “Prof.Asoc.”, dhe 1 lektorë me Msc; Për vitin akademik **2021-2022** janë të angazhuar 9 pedagogë gjithsej, ndër të cilët **7 PAE** nga ku **1 me titullin “Prof.Asoc.”**, **5 me gradën “Dr”** dhe 1 lektorë me Msc dhe 2 PAK nga ku 1 me titullin “Prof.Asoc.”, dhe 1 me gradën “Dr”.

GVJ e konsideron këtë rekomandim të **përbushur plotësisht**.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë caktoi: Prof.Asoc. Dr Enkelejda OLLDASHI si dhe Prof. Asoc.Dr Jola BODE si ekspertë të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit Bachelor në “Juridik i Përgjithshëm” të ofruar nga Universiteti Europian i Tiranës (UET). Gjatë vizitës në institucion dhe procedurës lidhur me vlerësimin e jashtëm, ekspertët e jashtëm u asistuan nga përfaqëuesja e ASCAL Majlinda Demireli.

Procedura e vlerësimit të jashtëm filloi me trajnimin e grupit të vlerësimit të jashtëm pranë ASCAL, vijoi me takime paraprake për shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar nga UET, ndarjen e punës dhe organizimin e vizitës pranë institucionit. Në bashkëpunim me përfaqësuesen e ASCAL, u dakortësua për ditët e zhvillimit të vizitës në institucion si dhe u hartua axhenda e takimeve. Përfaqësuesja e ASCAL dërgoi axhendën e takimeve pranë institucionit i cili konfirmoi dakortësinë e tij.



Vizita në institucion u zhvillua në datat 06 dhe 07 Qershor. Gjatë vizitës dy ditore GVJ zhvilloi takime me Dekanen e Fakulteti të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Përgjegjësen e Departamentit të Shkencave Juridike, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik të brendshëm dhe të jashtëm të angazhuar në këtë program studimit, përfaqësues të Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, *Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave*, *Zyrës së Projekteve*. Në ditën e dytë të takimit, GVJ zhvilloi vizita pranë Sekretarisë Mësimore, Bibliotekës si dhe në ambientet e zhvillimit të mësimit për këtë program studimit. Gjatë vizitës në institucion, GVJ kërkoi materiale dhe dokumentacion shtesë të cilat u vënë në dispozicion në faqen zyrtare të ASCAL dedikuar procedurës lidhur me këtë program studimi. Pas vizitës në institucion, GVJ pasi diskutoi problematikat e paraqitura dhe rishqyrtoi të gjitha materialet e vëna në dispozicion nga institucioni, filloi punën për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm (RVJ).

Universiteti European i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 31.08.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 87/93 Prot, datë 31.08.2022. Universiteti European i Tiranës përcjell në ASCAL më datë 12.09.2022, me anë të shkresës me Nr. 120/15 Prot, datë 08.09.2022, “Kthim përgjigje mbi draft RVJ, për programin Bsc Juridik i Përgjithshëm”. GVJ pasi u njoh me komentet e shprehura në relacion mbi draft raportin e hartuar mbi programin e studimit Bachelor në “Juridik i përgjithshëm”, shprehet si vijon:

1. Për komentin e IAL-së mbi konstatimin e GVJ-së që i referohet **Standatit III.1/Kriteri 5**;

**Vlerësimi i ekspertëve të GVJ-së për kriterin e mësipërm është:**

Institucioni evidenton në mënyrë të vazhdueshme ato raste që i gjykon si positive përgjatë procesit të mësimdhënies dhe i bën ato të njohura për anëtarët e tjerë (sipas RVB-së). *GVJ rekomandon që ky proces duhet të dokumentohet, pasi në raport apo në dokumentat e depozituara nuk rezulton të këtë ndonjë dokument të tillë, përveç faktit të deklaruar në RVB.*

**Komentet nga Institucioni:**

UET siguron një program trajnimi të strukturuar për personelin akademik me gradën shkencore dhe angazhimin në hulumtim. Këto trajnime dokumentohen në një process zinxhir me anë të thirrjes në formë poster në rrjetet sociale, me anë të një emaili dërguar personelit akademik, si dhe mbajtjes së materialeve të përdorura gjatë trajnimit. Në raportin e RVB, këto të dhëna janë evidentura me anë të posterave në **dokumentin Ref. Nr.33. “Të dhëna për trajnime profesionale të stafit dhe të studentëve”**.

**Argumenti i GVJ:**

**Sipas standatit III.1/Kriteri 5: *Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.***

Për sa më sipër, rekomandimi i GVJ-së lidhet me evidentimin nga ana e institucionit të praktikave të mira të mësimdhënies dhe jo vetëm me trajnimin e stafit akademik. Në RVJ janë evidentuar trajnimet që realizohen nga institucioni për stafin akademik dhe studentët. Tek ky kriter është gjykuar që ato nuk kanë qenë të nevojshme që të evidentohen me Referencen nr.33



“Të dhëna për trajnime profesionale për stafin dhe studentët”. Për sa më sipër, GVJ riformulon fjalinë si më poshtë:

*GVJ-ja rekomandon që praktikat e mirë të mësimdhënies të evidentohen/dokumentohet dhe të bëhen të njohura për anëtarët e njësisë kryesore/bazë.*

**2. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ që i referohet Standarti VI.3/Kriteri 4;**

**Vlerësimi i ekspertëve të GVJ:**

*Nëpërmjet Rjetit ALUMINI janë mundësuar aktivitete me studentët e diplomuar, por nuk ka të dhëna në lidhje me sondazhet e kryera në kuadrin e rrjetit Alumini.*

**Komentet nga Institucioni:**

Në vijim të vizitave në UET, janë vënë në dispozicion të Ekspertëve evidencë shtesë mbi përdorimin e sondazheve drejtuar ALUMNI në nivel Departamenti, të cilat shërbejnë për vlerësimin e dijeve dhe kompetencave të përfitura nga programi i studimit (**Dokumenti shtesë Ref. nr. 4.1. Pyetësi ALUMNI-Shkurt 2022, Ref. Nr.4.2. Kujdesi ndaj ALUMNI përgjigjet e pyetësit**).

**Argumenti i GVJ:**

GVJ e ka vlerësuar **Standartin VI.3/Kriteri 4** në tërësinë e tij pozitivisht. Komenti i dhënë i referohet mungesës së kësaj evidence në argumentimin e **Standarti VI.3/Kriteri 4** në RVB hartuar nga institucioni, ku pyetësorët e studentëve të diplomuar ALUMNI nuk janë specifikuar si instrumenta të vlerësimit të cilësisë dhe mbarëvajtjes së programit. I referohet gjithashtu mungesës së kësaj evidence në listën e dokumenteve mbështetëse për procesin e akreditimit të programit të studimit Bachelor në “Juridik i përgjithshëm”, bashkëngjitur RVB. Sa i takon evidencave shtesë mbi përdorimin e sondazheve drejtuar ALUMNI në nivel Departamenti, të cilat shërbejnë për vlerësimin e dijeve dhe kompetencave të përfitura nga programi i studimit, vënë në dispozicion pas vizitës në institucion, jemi të mendimit se dokumenti i paraqitur, referuar numrit të studentëve të intervistuar nuk është përfaqësues për tu konsideruar si një instrument vlerësimi të programit të studimit. **Për sa më sipër, GVJ riformulon fjalinë si më poshtë:**

*“Nëpërmjet Rjetit ALUMINI janë mundësuar aktivitete me studentët e diplomuar, por sondazhet duhet të jenë më përfaqësuese në mënyrë që konkluzionet të jenë më të qëndrueshme”.*



## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Juridik i Përgjithshëm”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi I.1</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare (si një prej njësive kryesore të Universitetit European të Tiranës), pranë të cilit ofrohet programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Juridik i Përgjithshëm”, garanton që programet e studimit të ofruara të jenë në përputhje me vlerat dhe interesat kombëtare, bazuar në vizionin dhe statutin e institucionit. <i>Evidenca nr.2 “Statuti i UET-së”</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Juridik i Përgjithshëm”, synon të jap për studentët njohuri të konsoliduara akademike, duke mos cënuar vlerat akademike kombëtare. <i>Evidenca nr.3 “Rregullorja e programit të studimit BA Juridik I Përgjithshëm”</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Juridik i Përgjithshëm” ofrohet duke respektuar qëllimin dhe misionin e institucionit dhe njësisë kryesore, në bazë të të cilave është ofrimi i një edukimi cilësor. Ky program studimi synon të përgatisë një brez juristësh të aftë për tu përballur me nevojat në rritje të zhvillimit ekonomik të vendit. Studentëve ju ofrohet një edukim i përgjithshëm në fushën e jurisprudencës, duke dhënë mundësinë e vijimit të studimeve në fushat më specifike të ligjit. <i>Evidenca nr.3 “Plani Strategjik i UET-së 2015-2020”</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Universiteti European i Tiranës (UET) dhe njësia kryesore e tij Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, mbështeten në aktet e brendshme strategjike të institucionit për të ndërtuar dhe ofruar programet e studimit apo ofertën e tyre akademike. <i>Evidenca nr.3 "Plani Strategjik i UET-së 2015-2020"</i></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstron se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Akti themeltar i institucionit (Statuti i UET-së), është i miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe janë në zbatim dhe të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Përmes këtij akti themelor është përcaktuar mënyra e organizimit dhe funksionimit të strukturave akademike dhe strukturave të tjera ndihmëse, në funksion të programeve të studimit të ofruara, duke përfshirë dhe programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në "Juridik i Përgjithshëm".</p> <p><i>Evidenca nr.2 "Statuti i UET-së"; Evidenca nr.7 "Rregullorja e programit të studimit BA Juridik i Përgjithshëm";</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në "Juridik i Përgjithshëm" ofrohet nga Departamenti i Shkencave Juridike (si njësia bazë) në përputhje me emërtimin dhe përmbajtja e tij. Ky program studimi është në përputhje dhe me fushën akademike të njësisë kryesore dhe atë të drejtimit të institucionit. <i>Evidenca nr. 2 "Statuti i UET-së".</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.3</b></p> <p><b>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Regullorja e programit të studimit Bachelor në "Juridik i Përgjithshëm" (pika 3.3) ka të përcaktuara qartë objektivat formuese, duke përcaktuar si ato të përgjithshme, ashtu dhe ato specifike. Ky program studimi mundëson një formim të përgjithshëm në fushën juridike.</p> <p><i>Evidenca nr.7 "Rregullorja e programit të studimit BA Juridik i Përgjithshëm".</i></p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Institucioni (UET) ka krijuar një strukturë të posacme (Bordi i Tregut të Punës), e cila u mundëson njësive kryesore dhe bazë në përcaktimin të ndërmarrin iniciativa për përmirësimin e kurrikulave akademike. Bordi i Tregut të Punës, përbëhet nga ekspertë të jashtëm, anëtarë të njësive dhe nga alumni të programeve përkatëse. Ky bord funksionon deri në nivelin e njësive bazë. Njësia bazë mbështetet nga bordi për të krijuar lidhje të vazhdueshme me tregun e punës. Përmirësimet e kurrikulës realizohen edhe duke u mbështetur në rekomandimet e këtij bordi, i cili ka t drejtë që të bejë rekomandimet përkatëse.</p> <p><i>Evidenca nr.12 "Bordi i Tregut të Punës".</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Juridik i Përgjithshëm" është i organizuar në funksion të përmbushjes së objektivave të përgjithsme dhe specifike. Këto objektiva lidhen me realizimin e procesit akademik të mësimdhënies dhe nxënies përgjatë gjithë periudhës së studimeve. Një ndër objektivat e programit të studimit lidhet dhe me punësimin e studentëve në fushën e juridprudencës, si dhe vijimi i studimeve në ciklet e tjera të studimeve.</p> <p><i>Evidenca nr. 7 "Rregullorja e programit të studimit BA Juridik I Përgjithshëm".</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.4</b></p>	
<p><b>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Juridik i Përgjithshëm" ofrohet nga njësia bazë Departamenti i Shkencave Juridike, i cili është një prej njësive bazë të Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare për vitin akademik 2021-2022 ka gjithsej <b>31 pedagogë</b>, nga të cilët <b>25 janë pedagogë efektiv (PAE)</b> nga ku: 7 kanë titullin "Profesorë", 4 kanë titullin "Profesorë të</p>



	<p>Asociuar”, 9 kanë gradën Dr., dhe 5 Asistent Lektorë me Msc; dhe <b>6 pedagogë me kontratë (PAK)</b> nga ku 1 ka titullin “Profesor”, 1 ka titullin “Profesorë i Asociuar”, dhe 4 kanë gradën Dr.</p> <p>Ndërsa Departamenti i Shkencave Juridike për vitin akademik 2021-2022 ka <b>9 PAE</b>, nga ku 1 ka titullin “Profesor”, 2 kanë titullin “Profesorë të Asociuar” dhe 6 kanë gradën “Dr” dhe <b>5 PAK</b> nga ku 1 ka titullin “Profesor”, 1 ka titullin “Profesorë i Asociuar” dhe 3 kanë gradën “Dr”.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga PAE &amp; PAK, përkatësisht sipas viteve akademike:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Viti akademik 2018-2019 – 3 me titullin akademik prof; 4 me titullin akademik Porf.Asoc; 14 me gradën shkencore DR dhe 18 me Msc (39 staf akademik);</li> <li>- Viti akademik 2019-2020 – 4 me titullin akademik prof; 2 me titullin akademik Porf.Asoc; 9 me gradën shkencore DR dhe 10 me Msc (25 staf akademik);</li> <li>- Viti akademik 2020-2021 – 43 me titullin akademik prof; 1 me titullin akademik Porf.Asoc; 8 me gradën shkencore DR dhe 7 me Msc ( 18 staf akademik);</li> </ul> <p>Në bazë të të dhënve të mësipër, institucioni demonstron që plotëson kriteret e nevojshme, në lidhje me burimet akademike për zhvillimin e këtij program studimi.</p> <p><i>Evidenca nr. 20 “Tabelat me CV e stafit akademik”; Evidenca nr. 23 “Tabela me të dhënat e personelit akademik në njësinë kryesore”.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Juridik i Përgjithshëm” ofrohet brenda fushës akademike të njësisë bazë, si njësia përgjegjëse për zhvillimin e këtij program studimi.</p> <p>Departamenti i Shkencave Juridike, si njësia bazë përgjegjëse, ofron dhe programe të tjera studimi në fushën e jurisprudencës, të cilat mbështesin aspektin akademik dhe shkencor në këtë program studimi.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas</p>	<p>Fusha e përgjithshme e studimit në këtë program studimi është në përputhje me fushën e përgjithshme të njësisë bazë (Departamenti i Shkencave Juridike). Ky është një program studimi që ofrohet nga njësia bazë përgjegjëse dhe është brenda disiplinës përkatëse akademike. Departamenti bashkëpunon me njësitë e tjera akademike (që janë pjesë e</p>



klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	njësisë kryesore) për zhvillimin e lëndëve të karakterit të formimit multidisiplinor.  <i>Evidenca nr.2 "Statuti i UET-së"; Evidenca nr.5 "Rregullorja e UET-së"; Evidenca nr.7 "Rregullorja e programit të studimit BA Juridik I Përgjithshëm".</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi I.5

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Institucioni (UET) është i organizuar në njësitë kryesore dhe ato bazë, të cilat kanë detyra dhe funksiona të ndara dhe të mirëpërcaktuara në aktet themelore të institucionit. Të gjitha njësisë e kanë të organizuar punën e tyre në funksion të procesit akademik dhe shkencor. Organizimi i strukturave akademike vendimmarrëse është i përcaktuar në aktet përkatëse. Programet e studimit mbështeten në aspektin procesimit akademik dhe nga koordinatorët përkatës, të përzgjedhur nga anëtarët e departamentit.  <i>Evidenca nr.5 "Rregullorja e UET-së"; Evidenca nr.6 "Organizimi dhe funksionimi i dekanatit"; Evidenca nr.36 "Koordinatorët e programit".</i>
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.	Institucioni (UET) ka marrëveshje në nivel insitucional, të cilat janë dhe në funksin të programit të studimit Bachelor në "Juridik i Përgjithshëm". Marrëveshjet në nivel insitucional janë dhe në kuadër të strategjisë së ndërkombëtarizimit të institucionit. Në funksion të programit të studimit Bachelor në "Juridik i Përgjithshëm" janë marrëveshjet që njësia kryesore ka lidhur me institucionet vendase publike dhe private. Këto marrëveshje janë të lidhura dhe me qëllimin e realizimit të praktikavë profesionale.  <i>Evidenca nr. 7 "Rregullorja e programit të studimit BA Juridik I Përgjithshëm". Evidenca nr.32 "Lista e insitucioneve</i>



	<i>bashkëpunuese për programin bachelor”; Evidenca nr. 4 “Plani strategjik për zhvillimin e programit bachelor”.</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Juridik i Përgjithshëm” harton për cdo vit akademik një raport analitik, ku ndër të tjerave, analizohen dhe përfitimet apo efektshmëria e marrëveshje të lidhura në nivelin e njësisë bazë/kryesore. Kjo analizë është në funksion të rritjes së qëllimit të këtyre marrëveshjeve dhe të procesit akademik.  <i>Evidenca nr.35 “Raporti i përfitimit nga marrëveshjet”.</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Në funksion të realizimit të praktikave profesionale janë jo vetëm marreveshjt përkatëse, por dhe strukturat përgjegjëse të institucionit. Studentët drejtohen dhe orjentoohen nga stafi akademik përgjegjës për praktikën. Kjo është e përcaktuar dhe në rregulloren e programit të studimit në mënyrë specifike, si dhe në dokumentin përkatës që lidhet me praktika.  <i>Evidenca nr.32 “Mbi praktika profesionale”.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	UET ofron në vijimësi të programit të studimit, por edhe pas përfundimit të tij trajnime dhe takime me të diplomuarit. Ky proces realizohet përmes strukturave të detikuara për të realizuar këtë objektivi të institucionit (klubet studentore & alumni). <i>Evidenca nr.33 “Të dhëna për trajnimet profesionale”</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të	Programi i studimit Bachelor në “Juridik i Përgjithshëm” është një program tre vjeçar me së paku 180 ECTS. Programi është



<p>vlerësuar në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>i organizuar në bazë të krediteve ECTS. Numri i krediteve për lëndët/modulet varion nga 5 ECTS deri në 8 ECTS. Programi është i organizuar në dy semestra për çdo vit akademik.</p> <p><i>Evidenca nr. 7 "Rregullorja e programit të studimit BA Juridik I Përgjithshëm".</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Juridik i Përgjithshëm" synon formimin e përgjithshëm të studentëve në fushën e drejtësisë. Qëllimi dhe objektivat e programit realizohen përmes grup lëndëve të kategorisë së formimit të përgjithshëm, formimit specifik dhe atij ndërdisiplinor.</p> <p><i>Evidenca nr. 7 "Rregullorja e programit të studimit BA Juridik I Përgjithshëm".</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparura në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Juridik i Përgjithshëm" është i organizuar në formën e lëndëve/moduleve, të cilat synojnë të pajisin studentët me; aftësi komunikuese në fushën e jurisprudencës; aftësi interpretative; dhe aftësi analitike. Lëndët/modulet që realizojnë synimet e këtij program ofrohen në të tre vitet akademike.</p> <p><i>Evidenca nr. 7 "Rregullorja e programit të studimit BA Juridik I Përgjithshëm"; Evidenca nr.14 "Kurrikula".</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Juridik i Përgjithshëm" është i organizuar në bazë të krediteve ECTS, të cilat kanë të përcaktuara qartësisht numrin e orëve mësimore në auditor (në formën e leksioneve dhe seminareve) dhe orët e punës individuale të studentit. Orët e punës në auditor mundësojnë përmes orëve të leksioneve dhe seminareve krijimin e një mjedisi akademik komunikues mes pedagogëve dhe studentëve. Programet e lëndëve/moduleve kanë të pasqyruar qartë temat e leksioneve dhe seminareve, literaturën përkatëse, komponentët e kontrollit të dijeve, mënyrën e vlerësimit. Programet e lëndëve/moduleve përmbajnë dhe numrin e krediteve ECTS, si dhe orët përkatëse në auditor dhe jashtë auditorit. Këto programe kanë dhe kontaktet e grupit të pedagogëve që mbulojnë lëndën.</p> <p><i>Evidenca nr. 7 "Rregullorja e programit të studimit BA Juridik I Përgjithshëm"; Evidenca nr.14 "Kurrikula".</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Juridik i Përgjithshëm" është i organizuar në kategoritë përkatëse të lëndëve, sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Juridik i Përgjithshëm" është i organizuar në kategoritë përkatëse të lëndëve, sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>



dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	<i>Evidenca nr. 7 "Rregullorja e programit të studimit BA Juridik i Përgjithshëm"; Evidenca nr.14 "Kurrikula".</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Programi i studimit Bachelor në "Juridik i Përgjithshëm" ofrohet nga njësia bazë përgjegjëse Departamenti i Shkencave Juridike, i cili është një prej njësive bazë të Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Kjo njësi përhjegjëse bazë, plotëson të gjitha detyrimet e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për procesin e akreditimit. <i>Evidenca nr. 2 "Statuti i UET-së"</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	Departamenti i Shkencave Juridike, i cili është njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, ka caktuar koordinatorin përkatës. Detyrat dhe funksioni i koordinorit janë të përcaktuara në aktin e brendshëm administrativ të miratuar nga njësia përkatëse. Funksioni kryesor i kordinatorëve është koordinimi i procesit akademik në aspektin akedmik dhe administrative; ndjekja e zhvillimit të praktikave profesionale etj. Koordinate për këtë program studimi është një prej anëtarëve të stafit akdemik, e cila është me gradën shkencore Phd. <i>Evidenca nr.36 "Koordinatorët e programit"</i> .
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare ka në përbërje tre njësi bazë: 1. Departamenti i Shkencave Juridike; 2. Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara; 3. Qendra për Metodologjinë dhe Kërkimin Shkencor;  Departamenti i Shkencave Juridike ofron studime në pesë programe, një të ciklit të parë bachelor, dhe katër të ciklit të dytë. Struktura e organizimit të njësisë kryesore është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kjo stukturë ka numrin e nevojshëm të stafit akademik për ofruar
<b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e	



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi II.3

**Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare (si njësia kryesore) dhe Departamenti i Shkencave Juridike (si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit BA në “Juridik i Përgjithshëm”) disponojnë të gjithë informacionin e nevojshëm, në lidhje me funksionimin dhe organizimin e strukturave akademike dhe administrative përkatëse. <i>(nga vizita e GVJ-së në institucion- minutat e takimit)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Programi i studimit BA në “Juridik i Përgjithshëm”, është një program 3-vjecar studimi, i organizuar në dy semestra për cdo vit akademik (në gjashtë semestra gjithsej). Ngarkesa akademike për cdo semestër është 30 ECTS ose 60 ECTS për cdo vit akademik (RVB-ja). Lëndët janë të grupuara në kategoritë përcaktuese në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Rregullorja e institucionit dhe e programit të studimit, kanë të përcaktuara dhe masën e frekuentimit të procesit mësimor në auditor, e cila është në masën 60%.  Programet e lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm didaktik dhe akademik për studentët. Në fillim të cdo semestri, studentët njihen me përmbajtjen dhe komponentët e programit të cdo lënde. Studentët përmes sistemit LMS aksesojnë programet e lëndëve. Në këto programe është dhe nunri i orëve që zhvillohen në auditor dhe orët individuale. Mënyra e vlerësimit të dijeve, si dhe komponentët e vlerësimit janë pjesë e cdo program lënde dhe ato i bëhen të njohura studentëve në fillim të procesit mësimor. Mënyra e hartimit të programeve të lëndëve është e përcaktuar dhe rregulluar dhe në bazë të aktit të miratuar nga institucioni, i cili lidhet me parimet e ndërtimit të syllabusit. Literatura e përcaktuar në programet e lëndëve është e ndarë në atë të detyrueshme dhe të rekomanduar, e cili vihet në dispozicion studentëve në rrugë elektronike ose hard copy. Ajo aksesohet dhe në bibliotekën e institucionit.
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	
<b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit,	



<p>kualifikimit të personelit akademik.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>programet e studimit, duke përfshirë dhe programin BA në “Juridik të Përgjithshëm”</p> <p>Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare për vitin akademik 2021-2022 ka gjithsej <b>31 pedagogë</b>, nga të cilët <b>25 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 6 pedagogë me kontratë (PAK).</b></p> <p>Stafi akademik sipas departamenteve për vitin akademik 2021-2022:</p> <p><b><u>Departamenti i Shkencave Juridike:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 9 PAE, ndër të cilët 8 me tituj / grada;</li> <li>- 5 PAK, ndër të cilët, 5 me tituj / grada;</li> </ul> <p><b><u>Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 9 PAE, ndër të cilët 6 me tituj / grada;</li> <li>- 1 PAK, me gradë shkencore;</li> </ul> <p><b><u>Qendra për Metodologjinë dhe Kërkimin Shkencor::</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 7 PAE, ndër të cilët 3 me tituj / grada;</li> <li>- 0 PAK;</li> </ul> <p>Ndërsa stafi akademik i Departamentit të Shkencave Juridike që është përgjegjës për programin e studimit për tre vitet akademike në raportet PAE/PAK është si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik <b>2019-2020, (12 PAE / 8 PAK)</b>, nga këta me grada/tituj shkencore <b>9 / 5;</b></p> <p>Për vitin akademik <b>2020-2021, (11 PAE/ 8 PAK)</b>, nga këta me grada/tituj shkencore <b>10 / 4;</b></p> <p>Për vitin akademik <b>2021-2022, (9 PAE / 5 PAK)</b> nga këta me grada/tituj shkencore <b>9 / 5;</b></p> <p>Për sa më sipër kualifikimi i stafit akademik është në përputhje me nurrin dhe kualifikimet e kërkuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, si njësi kryesore ku ofrohet ky program studimi, përmbush standardet e organizimit/strukturimit akademik dhe administrative, për të ofruar programe të studimit të ciklit të parë.</p> <p><i>Evidenca nr.2 “Statuti i UET-së”</i></p> <p><i>Evidenca 0.2. Tabela përmbledhëse për Aneks RVB - BA Juridik i Përgjithshëm.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr.6 “Për organizimin dhe funksionimin e departamentit”</i></p>
---	---



<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Emërtimi dhe përmbajtja e kurrikulës së programit të studimit BA në “Juridik i Përgjithshëm” është brenda fushës përkatëse të studimit të ofruar nga njësia bazë përgjegjëse. Ky program studimi ka objektiva të parashikuara në rregulloren e programit, të cilat lidhen me qëllimin e zhvillimit të studimeve në këtë program dhe me njohuritë që ofrohen për gjatë periudhës akademike (tre viteve). Te gjitha lëndët/modulet janë të organizuara në formën e krediteve ECTS. Në çdo syllabus janë të shprehura qartë objektivat e programit të lëndës dhe rezultatet e mundshme të të nxënurit. Komponentët e vlerësimit janë përgjatë gjithë semestrit ku lënda zhvillohet. Për çdo komponentë të kontrollit të dijeve janë të përcaktuara dhe pikët apo % përkatëse të vlerësimit/ kontrollit të dijeve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënurit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Programi i studimit BA në “Juridik i Përgjithshëm” është program i ciklit të parë të studimeve dhe andaj shumica e lëndëve janë të karakterit teorik, por në program ka dhe një grup lëndësh që janë të lidhura me praktikën gjyqësore si procedura civile &amp; penale, si dhe lëndë të tjera. Pjesë e kurrikulës janë dhe një grup lëndësh që ofrojnë njohuri të thelluara akademike dhe shkencore, në masën 15% (sipas RVB-së). <i>Evidenca nr.14 “Kurrikula”; Evidenca nr.14.2 “Plani mësimor”</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Në programin e studimit BA në “Juridik i Përgjithshëm”, grupimi i lëndëve në lëndë të karakterit teorik, praktik dhe krahasues, japin mundësi për studentët që të krijojnë opinione të panvarura në fushën e jurisprudencës. Veprimtaritë lëndore ofrojnë gjithashtu mundësi që studentët të kryejnë punë të panvarur kërkimore dhe analitike. <i>Evidenca nr.14 “Kurrikula”.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, përmirëson në mënyrë të vazhdueshme syllabuset e lëndëve dhe kurrikulën, në rastet e nevojshme. Ky proces realizohet dhe me mbështetjen e bordit të Tregut të Punës. Përmirësimi i syllabuseve realizohet nga stafi akademik, si në lidhje me literaturë, ashtu dhe me temat e programit mësimor.</p> <p><i>Evidenca nr.14 “Kurrikula”; nga takimi në institucionin i GVB-së me stafin akademik.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Departamenti i Shkencave juridike, përmes raportit vjetor, analizon syllabuset e lëndëve dhe arritjen objektivave të përcaktuara. Programi i studimit BA në “Juridik i Përgjithshëm” ofron njohuritë e nevojshme në fushën e</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të</p>	<p>Departamenti i Shkencave juridike, përmes raportit vjetor, analizon syllabuset e lëndëve dhe arritjen objektivave të përcaktuara. Programi i studimit BA në “Juridik i Përgjithshëm” ofron njohuritë e nevojshme në fushën e</p>





transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të lëndëve, janë të përcaktuara në rregulloren e institucionit dhe atë të këtij program studimi.			
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	<i>Evidenca nr.5 "Rregullorja e UET-së"; Evidenca nr.7 "Rregullorja e programit të studimit BA Juridik i Përgjithshëm"; Evidenca nr.14 "Kurrikula"; Evidenca 14.1 "Plani mësimor i programit"; Evidencanr.28 "Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve"; Evidenca nr.38 "Mbi parimet e ndërtimit të lëndës".</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Rregullorja e programit të studimit ka të përcaktuar përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulës dhe përmirësimin e programeve të lëndëve (neni 10). Njësia bazë është struktura që inicion vendimin për rishikimin e kurrikulës. Pas dakortësisë në nivelin e njësisë bazë, vendimi vijon në strukturat e tjera akademike.  <i>Evidenca nr.52 "Procedura për ndryshimin e kurrikulës".</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënljore në fuqi.	Programi i studimit BA në "Juridik i Përgjithshëm" ofrohet nga Departamenti i Shkencave Juridike në tre vite akademike, me kohe të plotë. Ngarkesa mësimore është e normuar në formën e krediteve ETS. Totali i orëve në auditor, sipas rregulloreve të programit dhe kurrikulës përkatëse, është brenda normave akademike për një program studimit të ciklit të parë (810 orë akademike).  <i>Evidenca nr.7 "Rregullorja e programit të studimit BA Juridik i Përgjithshëm"; Evidenca nr.14 "Kurrikula"; Evidenca nr.10.4 "Kalendari akademik"</i>



synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	jurisprudencës dhe përmes tij studentët aarrjnë aftësitë dhe kompetencat e duhura në këtë fushë.  <i>Evidenca nr. 38 "Analiza e departamentit për arritjen e objektivave"</i>			
<b>Kriteri 8.</b> Përbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit BA në "Juridik i Përgjithshëm" mundëson për të diplomuarit vijimin e studimeve në ciklin e dytë të studimeve (në Master shkencor & Master professional), pasi mënyra e ndërtimit të kurrikulës mundëson njohuritë e nevojshme për vijimin e mëtejshëm të studimeve. Kurrikula është e përshtatur me nevojat e tregut të punës, pasi njësia bazë, duke u mbështetur dhe nga struktura përkatëse Bordi i Tregut të Punës, përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme syllabuset e lëndëve.  <i>Evidenca nr.2 "Statuti i UET-së"; Evidenca nr.7 "Rregullorja e programit të studimit BA Juridik i Përgjithshëm" Evidenca nr.12 "Bordi i Tregut të Punës".</i>			
<b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## Standardi II.5

**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Stafi akademik i angazhuar në program studimit BA në "Juridik i Përgjithshëm" përbëhet nga pedagogë me eksperiencë në fushën e juridprudencës. Në përbërjen e stafit akademik është numri i nevojshëm i pedagogëve që mbajnë tituj akademik/gradë shkencore, sipa përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të	Referuar të dhënave të depozituara nga institucioni rezultojnë që stafi i angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për gjatë tre viteve akademike është si më poshtë:  - Për vitin akademik <b>2019-2020</b> janë të angazhuar <b>25 pedagogë gjithsej</b> , ndër të cilët <b>19 PAE</b> nga ku 3 me titullin



<p>kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>“Prof.Dr.”, 2 me titullin “Prof.Asoc.”, 7 me gradën “Dr” dhe 7 lektorë me Msc dhe <b>6 PAK</b> nga ku 1 me titullin “Prof.Dr.”, 2 me gradën “Dr” dhe 3 lektorë me Msc.</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje është <b>76% PAE dhe 24% PAK.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>- Për vitin akademik <b>2020-2021</b> janë të angazhuar <b>18 pedagogë gjithsej</b>, ndër të cilët <b>16 PAE</b> nga ku 1 me titullin “Prof.Dr.”, 1 me titullin “Prof.Asoc.”, 8 me gradën “Dr” dhe 6 lektorë me Msc dhe <b>2 PAK</b> nga ku 1 me titullin “Prof.Asoc.”, dhe 1 lektorë me Msc.</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje është <b>88% PAE dhe 12% PAK.</b></p> <p>- Për vitin akademik <b>2021-2022</b> janë të angazhuar <b>9 pedagogë gjithsej</b>, ndër të cilët <b>7 PAE</b> nga ku 1 me titullin “Prof.Asoc.”, 5 me gradën “Dr” dhe 1 lektorë me Msc dhe <b>2 PAK</b> nga ku 1 me titullin “Prof.Asoc.”, dhe 1 me gradën “Dr”.</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje është <b>77% PAE dhe 23% PAK.</b></p> <p>Përvoja akademike dhe profesionale e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi është Brenda fushës përkatëse të studimit, si dhe në përputhje me qëllimin e dhe objektivat e programit.</p> <p><i>Evidenca nr. 20 “Tabelat me CV e stafit akademik”: Evidenca nr. 23 “Tabela me të dhënat e personelit akademik në njësinë kryesore”</i></p> <p><i>Evidencat shtesë gjatë vizitës në institucion.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi ka lidhur marrëveshjet e nevojshme për të arritur një bashkëpunim efektiv me kompanitë private, si dhe institucionet publike, për realizimin e orëve të dedikuara praktikave profesionale. Këto marrëveshje janë të lidhura më së shumti me studio ligjore apo kompani konsulente. Marrëveshjet shërbejnë edhe për të ndihmuar studentët për përgatitjen e temave të diplomës. Studentët asistohen gjatë ndjekjes së praktikave dhe pedagogët e caktuar nga departamenti.</p> <p><i>Evidenca nr. 34 “Marrëveshje bashkëpunimi”: Evidenca nr.32.1 “Mbi praktikat profesionale”</i></p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit BA në “Juridik i Përgjithshëm” asiston studentët gjatë zhvillimit të orëve praktike të zhvilluara në institucione apo kompani. Në këtë program studimi nuk ka të parashikuara orë laboratorike (sipas RVB-së).</p> <p><i>Evidenca nr.10 “Mbi punimin e diplomës”.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<p><b>Standardi III.1</b>  <b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Universitetit European të Tiranës (UET) ka hartuar në nivel institucional udhëzues për mënyrën e ndërtimit të programit të lëndëve, duke respektuar strukturën që është përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Hartimi i një dokumenti të tillë në nivel institucional, ndihmon në harmonizimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke u bazuar dhe tëk parimet dhe objektivat strategjike të institucionit.</p> <p><i>Evidenca nr.39 “Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndëve”.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë</p>	<p>Institucioni (UET) ka struktura që monitorojnë procesin e mësimdhënies. Ky proces monitorohet dhe vlerësohet edhe përmes instrumenteve të ndryshme sic janë: vlerësimi në auditor i stafit akademik nga drejtuesit e njësive (dekani,</p>



periodike aftësitë mësimit dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	përgjegjësi i departamentit); vlerësimi nga studentët; rezultatet e raporteve të KSBC-së. <i>Evidenca nr.40 "Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët"; Evidenca nr. 41 "Formularë të vlerësimit."</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimit, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Institucioni (UET) aplikon dhe formularët e vlerësimit të stafit akademik nga studentët, të cilat ruajnë anonimin dhe studentët kanë mundësi të bëjnë vlerësimin e tyre dhe komente të ndryshme. <i>Evidenca nr.40 "Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët."</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimit bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Pranë institucionit funksionon dhe KSBC-ja, si strukturë që mundëson mbledhjen e rezultateve nga instrumentat e vlerësimit të procesit mësimor. Këto rezultate i behën të njohura strukturave përkatëse. <i>Evidenca nr.5 "Rregullorja e UET-së".</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimit.	Institucioni evidenton në mënyrë të vazhdueshme ato raste që i gjykon si pozitive përgjatë procesit të mësimit dhe i bën ato të njohura për anëtarët e tjerë (sipas RVB-së). Institucioni deklaron në RVB që merren masë për stafin që duhet të trajnohet për të përmirësuar rezultatet e mësimit. <i>GVJ rekomandon që praktikave të mira të mësimit të evidentohen / dokumentohen dhe të bëhen të njohura për anëtarët e njësisë kryesore/bazë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimit, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikave të mira.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimit, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikave profesionale e klinike, orët e	Rregullorja e programit të studimit ka të përcaktuar format e zhvillimit të procesit mësimor, përmes leksioneve dhe seminareve në auditor. Kontrolli i dijeve realizohet përmes forma të ndryshme të kontrollit si detyra kursit, prezantime, essay. Të gjitha format e kontrollit të dijeve vlerësohen sipas pikeve/% të përcaktuara në syllabuset e lëndëve. Mënyra e realizimit të orëve të mësimit u konfirmua edhe me pedagogët



<p>hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>e programit të studimit të cilët cilësuan se aplikimi i metodave të ndryshme të mësimdhënies ishte një prioritet i punës së tyre.</p> <p><i>Evidenca nr.5 "Rregullorja e UET-së"; Evidenca nr.7 "Rregullorja e programit të studimit BA Juridik I Përgjithshëm".</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Stafi akademik në programin e studimit BA në "Jurudik i Përgjithshëm" mbështet nevojat e studentëve, përmes formave të ndryshme të mësimdhënies. Format e mësimdhënies janë të lidhura me natyrën përkatëse të lëndëve. Në disa nga lëndët e këtij programi ato zhvillohen në formën e diskutimeve dhe trajtimit/analizimit të rasteve nga praktika gjyqësore.</p> <p><i>(nga minutat e takimeve të GVJ-së në institucion me stafin akademik dhe studentët).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Institucioni (UET) mbështet stafin akademik përmes trajnimeve që lidhen me përmirësimin e procesit mësimor. Këto trajnime organizohen në mënyrë periodike me temë "Staff Development Day" (sipas RVB-së). Institucioni mbështet stafin akademik edhe përmes projekteve, në të cilat realizohet shkëmbimi i eksperiencës me partner ndërkombëtarë. Këto projekti lidhen me procesin e mësimdhënies dhe formave të transmetimit të dijeve.</p> <p><i>Evidenca nr.43 "Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit".</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit BA në "Jurudik i Përgjithshëm" ka eksperiencën e nevojshme profesionale për të zhvilluar një process akademik sipas standardeve akademike. Përvoja akademike dhe profesionale e stafit është e lidhur dhe me natyrën e lëndëve, të cilat zhvillon. Përvoja profesionale e stafit akademik inkurajon dhe nxit studentët në thellimin në mënyrë të panvarur të studimit. Stafi akademik e ndan përvojën e tij akademike, duke aplikuar metodat më të përshtatshme të transmetimit të dijeve. Metodatat e transmetimit të dijeve lidhen dhe me metodat e vlerësimit të tyre. Studentët inkurajohen të jenë sa më analitik në opinionet e tyre dhe t'i bazojnë ato në të dhëna konkrete. Këto realizohen përmes detyrave të kursit apo formave të tjera të kontrollit të dijeve. Mes studentëve ka një frymë etike komunikimi akademik dhe bashkëpunimi.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	



<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	<i>Evidenca nr. 20 "Tabelat me CV e stafit akademik; nga minutat e takimeve të GVJ-së në institucion me stafin akademik dhe studentët).</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Format e mësimdhënies janë të përcaktuar në dokumentat bazë të institucionit si, rregullorja e UET-së dhe rregullorja e programit të studimit. Format e mësimdhënies janë të përcaktuara në mënyrë të strukturuar dhe në një dokument që lidhet me ndërtimin e syllabuseve.  <i>Evidenca "Mbi parimet e ndërtimit të programeve të lëndës"</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Institucioni (UET) e zhvillon procesin akademik në një sipërfaqe rreth 7.545 m <sup>2</sup> , e cila përbëhet nga ambientet mësimore (salla leksioni dhe seminaresh). Në këtë sipërfaqe janë 15 salla leksioni dhe 13 salla seminaresh. Sallat e leksioneve janë me 1138 vende, ndërsa sallat e seminareve janë me 353 vende. Sallat e mësimore janë të pajisura me mjetet e nevojshme audiovizive si PC, vidioprojektorë. Përveç sallave të leksioneve dhe seminareve janë dhe laboratorët, të pajisura me mjetet e dhura didaktike dhe elektronike.  <i>Evidenca nr.42 &amp; 42.1 "Infrastruktura në funksion të programeve të studimit".</i>
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Ambjentet akademike (salla leksioneve, seminareve dhe laboratorët), janë të pajisura me programet e dhura kompjuterike. Stafi akademik e zhvillon procesin mësimor duke përdorur mjetet audiovizive të instaluar në sallat mësimore. Programi LMS, në funksion të stafit akademik dhe studentëve, mundësojnë një komunikim ndërmjet tyre. Ky system shërben për stafin akademik që të shkarkoj materialet



	<p>e nevojshme akademike për zhvillimin e procesit mësimor dhe për përgatitjen në mënyrë të pavarur të studentëve.</p> <p><i>Evidenca nr.46 "Mbi platformën LMS"</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, ka përfshirë në syllabuset e lëndëve literaturën e detyrueshme dhe të këshillueshme. Literatura që është pjesë e syllabuseve të lëndëve, si dhe materialet e tjera të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor, shkarkohet nga ana e pedagogëve në platformën elektronike LMS.</p> <p>Biblioteka online është në funksion të procesit mësimor dhe të këtij programi studimi. Kjo bibliotekë është pjesë e COBISS, system biblioteke online. Studentët kanë mundësi të konsultohen me tekstet/leteraturën fizike në ambjentet e bibliotekës, sipas orareve të publikuara. Katalogët e bibliotekës ndihmojnë studentët që të përdorin dhe tekste në gjuhë të huaja (online).</p> <p><i>Evidenca nr.42 &amp; 42.1 "Infrastruktura në funksion të programeve të studimit".</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Satfi akademik dhe studentët mbështeten në procesin e mësimdhënies dhe nxënies nga fondi i pasur i bibliotekës së institucionit. Tekstet dhe materialet e tjera akademike në gjuhë të huaj gjenden aksesohen elektronikisht në ambjentet e bibliotekës.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Në këtë program studimi nuk ka të parashikuar zhvillim të orëve laboratorike.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Institucioni ka të miratuar dhe një akt të brendshëm administrativ për përdorimin e platformës LMS, si nga stafi akademik ashtu dhe studentët (<i>Urdhëri mbi zbatimin e platformës LMS</i>). Kjo platformë, mundëson një komunikim në kohë reale mes stafit akademik dhe studentëve. Përmes kësaj platforme stafi akademik realizon në kohë reale njoftimet që lidhen me procesin mësimor. Studentët informohen edhe përmes kësaj platforme për kërkesat që lidhen me lëndët</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të</p>	




brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	specifike, si dhe me detyrimet e tyre akademike. Platforma rrit shkallës e transparencës dhe informimit të studentëve. <i>Evidenca nr. 46. "Urdhëri mbi zbatimin e platformës LMS"</i>			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, asiston studentët në përgatitjen e detyrave të ndryshme të kursit dhe në mënyrë të vecantë dhe në përgatitjen e temës së diplomës. Asistenca lidhet me faktin e mbështetjes për të përzgjedhur dhe identifikuar temën/fushën specifike të interesit të tyre. Institucioni ka hartuar dhe një dokument që lidhet me strukturën e përgatitjes së temës së diplomës. <i>Evidenca nr.10 "Mbi punimin e diplomës"</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies.	Institucioni ka ngritur një strukturë të brendshme të cilësisë (KSBC), e cila realizon procesin administrativ të vlerësimit periodik të mësimdhënies. Kjo njësi propozon ndryshime në drejtim të rritjes së cilësisë të procesit mësimdhënës. Kjo strukturë bashkëpunon me njësitë përbërëse të institucionit, në nivelin e njësisve kryesore dhe bazë. <i>Evidenca nr.30.1 "Plani i veprimit të KSBC"</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Departamenti i Shkencave Juridike, si njësi bazë kryesore për programin e studimit aplikon instrumente për realizimin e cilësisë së procesit mësimdhënës: vlerësimi nga drejtuesit dhe nga studentët. Përgjegjësi i Departamentit miraton syllabuset e hartuara, dhe bën vlerësimin e mësimdhënies. <i>Evidenca nr. 19.1 "Formati për hartimin e vlerësimit"; Evidenca nr.7.1 "Për systemin e vlerësimit të studentëve".</i>
<b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin	Njësitë përbërëse të institucionit inkurojnë stafin akademik për të aplikuar metoda interaktive të mësimdhënies. Ky aspekt



dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	lidhet dhe me lirinë akademike të ndërtimit të përmbajtjes së syllabuseve të lëndëve, në të cilat janë të përcaktuara dhe metodat e mësimdhënies.  <i>Evidenca nr. 5 "Rregullorja e UET-së"; Evidenca nr.7 "Rregullorja e programit"; Evidenca nr. 19 "Syllabuset".</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi mbështetet nga strukturat përkatëse të institucionit për rretijen e kualifikimit shkencor. Institucioni ka të miratuar strategjinë e kërkimit shkencor. Në strukturën e institucionit është dhe Qendra e metodologjisë dhe kërkimit, e cila ofron trajnime për zhvillimin e punës kërkimore në mënyrë të panvarur.  <i>Evidenca nr.3.2 "Strategjia e kërkimit shkencor"</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Njësitë akademike të institucionit mbështesin stafin akademik për përmirësimin e aftësive mësimdhënëse, përmes shkëmbimit të eksperiencës me kolegë të ftuar në institucion. Institucioni mundëson dhe shkëmbim eksperience, përmes projekteve ndërkombëtare. Kjo realizohet përmes programeve Erasmus +. <i>Evidenca nr.43 "të dhëna për shkëmbim stafi"</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përmirëson në mënyrë të vazhdueshme syllabuset e lëndëve dhe një ndër komponentët lidhet dhe me metodat e mësimdhënies apo komponentët e kontrollit të dijeve. Komponentët e vlerësimit janë të lidhura dhe më përmbajtjen dhe qëllimin e lëndës. Në lëndë të caktuara metodat interaktive të mësimdhënies dhe nxënies janë një ndër komponentët. Personeli akademik ka lirinë të testojë metoda të reja në mësimdhënie, duke patur parasysh që edhe syllabuset rishikohen cdo fillim viti, për ti përshtatur me ndryshimet e nevojshme.  <i>Evidenca nr. 5 "Rregullorja e UET-së"; Evidenca nr.7 "Rregullorja e programit"; Evidenca nr. 19 "Syllabuset".</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X





<b>Standardi III.5</b>				
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregullorja e programit të studimit përcakton rregullat mbi të cilat zhvillohet procesi i vlerësimit të njohurive dhe dijeve të studentëve, të përfuara përgjatë procesit mësimor. Institucioni ka hartuar dhe akte të tjera që lidhen me procesin e vlerësimit të studentëve, të cilat i bëhen të njohura atyre në fillim të procesit akademik.  <i>Evidenca nr.7 "Rregullorja e programit"; Evidenca nr.7.1 Pwr systemin e vlerësimit të studentëve; Evidenca nr. 19 "Syllabuset".</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Stafi akademik informon studentët në fillim të çdo semestri akademik mbi komponentët e vlerësimit dhe format e kontrollit të dijeve. Këto komponentë akademik janë pjesë e syllabus-seve të lëndëve. Metodologjia dhe struktura e hartimit të testeve janë gjithashtu pjesë e informacionit që merret nga studentët, përmes stafit akademik.  <i>Evidenca nr.7.1 Pwr systemin e vlerësimit të studentëve; Evidenca nr. 19 "Syllabuset".</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Format e kontrollit të dijeve realizohen në forma të ndryshme, në varësi të natyrës së lëndës. Në programet e lëndëve përcaktohen format e kontrollit të njohurive dhe vlerësimi për secilin komponentë. Kontrolli i njohurive përbëhet nga disa komponentë dhe realizohet përgjatë gjithë semestrit akademik. <i>Evidenca nr.7.1 Pwr systemin e vlerësimit të studentëve; Evidenca nr. 19 "Syllabuset".</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale	Stafi akademik realizon procesin e kontrollit të dijeve/njohurive të studentëve, i cili përbëhet përgjatë gjithë semestrit akademik. Nota përfundimtare është rezultante e



<p>realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>kombinimit të provimit të ndërmejtëm; nivelit të diskutimeve të seminareve, detyrave të kursit dhe detyrave praktike.</p> <p><i>Evidenca nr.7.1 Pwr systemin e vlerësimit të studentëve; Evidenca nr. 19 "Syllabuset".</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Institucioni ka filluar aplikimin e sistemeve të korigjimit me programin "cleanscoring" (sipas RVB-së), për të realizuar një proces sa më transparent të korigjimit të testeve/provimeve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Sipas rregullores së programit të studimit, titullari i lëndës vlerëson përbërjen e komisionit të vlerësimit. Në disa nga detyrimet akademike si p.sh, praktika profesionale dhe detyrimet përmblyëse, komisioni përbëhet nga së paku 3 (tre) anëtarë. Provimet sekretohen dhe kjo procedurë realizohet nga strukturat përkatëse. Provimet monitorohen nga së paku 2 (dy) pedagogë, të caktuar nga departamenti. Pedagogu korigjon provimet dhe i dorëzon ato të sekretuaranë sekretarinë mësimore (sipas pikës 5.3.3 të rregullores së programit të studimit). Studentët njihen me rezultatet e provimet nëpërmjet sekretarisë mësimore. Në rastet e ankimit, studentët drejtojnë kërkesën përkatëse tek pedagogu dhe më pas tek drejtuesi i departamentit. Në këtë rast, drejtuesi i departamentit vlerëson rastin konkret dhe ngrë komisionin me së paku 3 (tre) anëtare (sipas pikës 5.8 të rregullores së programit të studimit).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p><i>Evidenca nr.7 "Rregullorja e programit"; Evidenca nr.7.1 Për systemin e vlerësimit të studentëve</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Tezat e provimit dhe format e tjera të detyrave (essay) kanë të përfshira rubrikën përkatëse për komentet/vlerësimin e pedagogut. Për sa më sipër, është hartuar dhe formati i tezës së provimit në të cilën është përcaktuar dhe rubrika "komente të pedagogut rreth përgjigjes për pyetjen ....".</p> <p>Ky format mundëson një proces transparent të vlerësimit dhe mundësi nga ana e studentëve për tu njohur me përgjigjet e sakta. Ky proces mundëson dhe një komunikim korrekt ndërmjet studentit dhe pedagogut. Vlerësimi i studentëve realizohet nëpërmjet sistemit të pikëve për çdo komponentë të kontrollit të dijeve dhe ato pasqyrohen në tezën e provimit apo në detyrën përkatëse të realizuar nga studenti. Institucioni ka të implementuar sistemin e kontrollit të plagjaturës,</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	



<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>përmes programit Turnitin Ephorus, i cili shërben për të kontrolluar detyrat/punimet e studentëve.</p> <p><i>Evidenca nr.7 "Rregullorja e programit"; Evidenca nr.7.1 Pwr systemin e vlerësimit të studentëve; Evidenca nr.7.2 Formatit i tezës së provimit.</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Institucioni aplikon systemin LMS dhe UMIS, përmes të cilëve studenti informohet në kohë reale për rezultatet e provimeve apo komponentëve të tjerë të vlerësimit të dijeve. Rregullorja e institucionit dhe e programit të studimit ka të parashikuar dhe kohën brenda të cilës dorëzohen rezultatet e provimeve si dhe kohën brenda të cilës studentët kanë të drejtë të paraqesin ankesën për rishikimin e provimit.</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p><i>Evidenca nr.5 "Rregullorja e UET"; Evidenca nr.7 "Rregullorja e programit";</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.7</b></p> <p><b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Juridik i Përgjithshëm" është një program që synon të ofrojë njohuri të përgjithshme dhe bazë në fushën e së drejtës. Lëndët e këtij program studimi i përkasin të dy fushave të së drejtës (publike dhe private) dhe janë të shpërndara në të tre vitet akademike. Lëndët e vitit të parë akademik synojnë të ofrojnë njohuri të përgjithshme në fushën e së drejtës dhe fusha të lidhura me të drejtën si psh., lënda "Hyrje në Sociologji", "Hartim dhe menaxhim projektesh", "praktikë dhe zhvillim karriere", të cilat synojnë të ndihmojnë studentët për të zhvilluar aftësitë sociale. <i>Evidenca nr.5 "Rregullorja e UET"; Evidenca nr.7 "Rregullorja e programit";</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të</p>	



<p>paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Juridik i Përgjithshëm” synon të nxisë të mësuarit analitik dhe kritik dhe kjo përmes mënyrës së ndërtimit të komponentëve të vlerësimit të dijeve. Një ndër komponentët që është pjesë e cdo syllabusi është dhe detyra/t e kursit që zhvillohen përgjatë javës së 11-13-të, të semestrit akademik. Stafi akademik orjenton studentët për strukturën dhe formën e testimit/provimit.</p> <p><i>Evidenca nr.7 “Rregullorja e programit”; Evidenca nr. 19 “Syllabuset”.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Stafi akademik në programin e studimit Bachelor në “Juridik i Përgjithshëm” e realizon formën e procesit mësimor në formën e diskutimeve (leksione dhe seminare), të cilat mundësojnë për studentët të përvetësuarit kritik të njohurive. Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi organizon dhe leksione të hapura, duke fituar specialist apo personalitet në fushën e drejtësisë dhe më gjerë.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në këtë program studimi, praktika profesionale është pjesë e kurrikulës. Praktika zhvillohet në institucionet publike dhe private, në varësi të interes të studentëve dhe në funksion të njohurive të përfutuara përgjatë viteve të studimit. Institucioni/Departamenti bën një analizë të përfuturit nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të praktikës profesionale.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Stafi akademik e organizon procesin mësimor edhe përmes grupeve te vogla të punës në klasë, duke mundësuar një debat profesional për çështjet apo temat specifike.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p><i>Evidenca nr.55 Kalendari i aktiviteteve 2019-0221; Evidenca nr.35 Marrëveshjet e bashkëpunimit; nga minutat e takimeve të GVJ-së në institucion me stafin akademik dhe studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijojnë klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Institucioni/departamenti nxit dhe mbështet kërkimin shkencor të stafit akademik, nëpërmjet botimeve në revistën e universitetit dhe përfshirjes në projekte.</p> <p><i>Evidenca nr.3.1 Strategjia e kwrkimit shkencor 2017-2020</i></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Juridik i Përgjithshëm” është i organizuar në formën e ECTS, të cilat mundësojnë transferimin e krediteve dhe mobilitetin e studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të</p>	



mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Institucioni është pjesë e programeve/projekteve Erasmus +KAI. Evidenca nr.28 Stafit dhe studentëve të angazhuar në projekte.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi III.8</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Institucioni ka të miratuar procedurën e posaçme për zhvillimin e provimit final/mbrojtjen e diplomës, e cila i bëhet e njohur studentëve. Ky dokument përmban rregullat dhe procedurat përkatëse për zbatim nga stafi akademik dhe komisionet përkatëse që krijohen në cdo rast. Për studentët me notë mesatare mbi 8.5, mundësohet mbrojtja e punimit të diplomës edhe më bazë të kërkeses së studentit.
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Stafi akademik informon dhe orjenton studentët për metodologjinë dhe strukturën e punimit të diplomës. Formatet përkatëse të hartuara lidhen me detyrimet e udhëheqësit, studentët dhe komisionit përkatës. Të gjitha këto dokumenta tregojnë për një transparencë dhe informim për realizimin e këtij procesi akademik.
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Njësia përkatëse publikon datat e mbrojtjes së provimit final dhe punimit të diplomës. Teza e provimi final hartohet sipas formatit të posaçëm dhe në bazë të përmbajtjes së kurrikulës së programit, sipas kategorive të grup lëndëve (20% kategoria A, 70% kategoria B, 10% kategoria C).  Studentët asistohen nga pedagogu udhëheqës për punimin e diplomës, përmes orëve metodologjike, ndërsa për provimin final, përmes takimeve të që realizohen në formën e konsultimeve/orjetimeve.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orjenton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	<i>Evidenca nr.10 Mbi punimin e diplomës; Evidenca nr.7.2 Mbi vlerësimin e studentëve; Evidenca 7.3 Mbi formatin e tezës së provimit)</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në	Stafi akademik asiston studentët që do të realizojnë punimin e diplomës, përmes orëve teorike dhe metodologjike. Këto



<p>mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>realizohen edhe përmes trajnimeve që njësia bazë realizon përgjatë vitit akademik, ku marrin pjesë studentët dhe pedagogët.</p> <p><i>Evidenca nr.10 Mbi punimin e diplomës; Evidenca nr.7.2 Mbi vlerësimin e studentëve; Evidenca 7.3 Mbi formatin e tezës së provimit.</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Stafi akademik përgjegjës për mbikqyrjen e punës së studentit për realizimin e punimit të diplomës, asiston dhe orjenton studentët në vijimësi të punës së tyre për përmbushjen e këtij detyrimi. Orët orjentuese konsistojnë në mënyrën e përdorimit të burimeve akademike, shkrimit të punimit, strukturës së punimit etj. <i>Evidenca nr.10 Mbi punimin e diplomës</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Studentët vlerësohen në përfundim të provimit final apo punimit të diplomës, sipas formularëve të përcaktuar nga institucioni. Rezultati përfundimtar shënohet në procesverbal dhe bëhet publik në fund të cdo séance të mbrojtjes së diplomave. <i>Evidenca nr.7.2 Mbi vlerësimin e studentëve; Evidenca 7.3 Mbi formatin e tezës së provimit</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Referuar DVV dhe evidencave përkatëse, rezultojnë se në përfundim Institucioni i pajis studentët me diplomën dhe suplementin përkatës, akte të miratuara, sipas legjislacionit në fuqi. <i>Evidenca nr.15 Modeli i diplomës &amp; suplementi.</i></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Studentët pajisen me të gjithë programet e lëndëve që janë pjesë e këtij program studimi dhe që i korrespondojnë kurrikulës së zhvilluar prej tyre për gjatë tre viteve të studimit. Këto dokumenta janë shqip dhe në anglisht dhe i vihen në dispozicion studentëve në përfundim të studimeve.</p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Institucioni administron, sipas rregullave në fuqi për arkivat dhe dokumentat zyrtare, të gjitha dokumentat që lidhen me studentin dhe procesin mësimor.</p> <p><i>Evidenca nr.5 Rregullore e UET-së</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>



				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, u konstatua se Zyra e Burimeve Njerëzore administron dosjet personale për të gjithë personelin akademik, si për PAE ashtu edhe për PAK, si dhe atë ndihmësimor-shkencor dhe administrativ si dhe bën përditësimin e vazhdueshëm të tyre. Dosja e personelit akademik përmban të dhëna personale, si dhe të dhëna lidhur me eksperiencën profesionale dhe kualifikimin shkencor, kontratën e punës si dhe vlerësimin e performancës.  <i>Evidenca nr.11 "Rregullore për burimet njerëzore", Evidenca nr.44.1, 44.2, "Format Dosje Staf Akademik".</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Institucioni ka procedura për rekrutimin e personelit akademik të cilat janë të reflektuara në Statutin e Universitetit dhe që ndiqen në mënyrë rigoroz nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Departamentet. Procedurat dhe kriteret e rekrutimit parashikohen në mënyrë të detajuar edhe në aktet rregullatore të institucionit, të cilat kanë për qëllim të përcaktojnë kushte që duhet të plotësohen në rekrutimin e stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. GVJ konstatoi që procedura e rekrutimit është në përputhje me Ligjin 80/2015 dhe Kodin e Punës në RSH.  <i>Evidenca nr.11 "Rregullore për burimet njerëzore".</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të	Aktet rregullatore të institucionit kanë parashikuar procedura të detajuara për përzgjedhjen e personelit akademik në përputhje



posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	me specifikat e programit. Kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të rekrutimit për personelit akademik publikohen në faqen web të UET ( <a href="http://www.uet.edu.al/reth/uet/">www.uet.edu.al/reth/uet/</a> ) si dhe në media. <i>Evidenca nr.11 "Rregullore për burimet njerëzore", Evidenca nr.11.1 "Shembull thirje për staf akademik".</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Procedura e rekrutimit dhe vlerësimit që institucioni zbaton, i referohet një sërë kriteresh të përgjithshme dhe specifike. Përzgjedhja bëhet me konkurim nëpërmjet dosjes, duke konsideruar kriteret e parashikura në rregulloren përkatëse lidhur me kualifikimin profesional si dhe përputhjen e kompetencave me natyrën e programit dhe përmbajtjes së lëndëve. Procedura e rekrutimit fillon me shpalljen e vendeve vakente ku përcaktohen kriteret e përgjithshme dhe specifike. Më tej vijohet me përzgjedhjen e dosjeve dhe intervistimin e kandidatëve nga Komisioni i Rekrutimit. <i>Evidenca nr.11 "Rregullore për burimet njerëzore", Evidenca nr.11.1 "Shembull thirje për staf akademik".</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Vizita në institucion dhe biseda me stafin akademik, GJV evidentoi se institucioni angazhohet për krijimin e një mjedisi dhe klime të përshtatshme dhe mundësi të barabarta për ushtrimin e veprimtarisë së personalit akademik të angazhuar në programin e studimit Bachelor "Juridik i përgjithshëm". Shfrytëzimi i mjediseve, infrastrukturës dhe kapaciteteve logjistike si dhe mbështetja nga institucioni mundësohej në përputhje me specifikat dhe nevojat e procesit të mësimdhënies.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe	Strukturat kompetente të institucionit mbështesin stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi në rritjen e kualifikimit shkencor dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional si një nga mënyrat kryesore të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Kualifikimi shkencor është pjesë e vizionit të Institucionit reflektuar në Strategjitë e



<p>administron programin e studimit.</p>	<p>Kërkimit Shkencor. Institucioni mundëson botimin e artikujve shkencore në revistën “Jus &amp; Justicia” e cila i referohet profilit juridik dhe botohet dy herë në vit si dhe pjesëmarrjen në aktivitetin shkencor “Ditët e Studimeve Shqiptare”. Njëkohësisht mundëson skema financimi sipas kushteve të përcaktuara. Kualifikimi shkencor i stafit akademik mbështetet edhe përmes projekteve kërkimore shkencore, projekteve të mobilitetit në të cilat realizohet shkëmbimi i eksperiencës me partnerë e institucione të huaja. Institucioni ka qënë përfitues i këtyre projekteve në kuadrin e ERASMUS +apo programeve të tjera të shkëmbimit.</p> <p><i>Evidenca nr.3.2 “Strategjia e kërkimit shkencor UET 2021-2025”, Evidenca nr.3.1 “Strategjia e kërkimit shkencor UET 2017-2020”, Evidenca nr.43 “Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit akademik”, Evidenca nr.28.1 “Projektet UET 2014-2020”, Evidenca nr.55 “Ditët e Studimeve Shqiptare”, Evidenca nr.55.1 “Kalendari I aktiviteteve”.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. <sup>1</sup></p>	<p>Institucionit mbështet dhe nxit stafin akademik për përmirësimin e aftësive mësimdhënëse, si dhe përdorimin e metodave inovative në procesin akademik edhe përmes trajnimeve. Pranë institucionit është ngritur Qendra e Metodologjisë dhe Kërkimit e cila zhvillon trajnime për rritjen e aftësisë së stafit akademik në veprimtari kërkimore.</p> <p>Në kuadrin e programeve për kualifikimin profesional të stafit, janë realizuar gjithashtu edhe trajnime për kualifikimin e stafit në përdorimin e teknologjive të reja te mësimdhënies dhe platformave on-line, si p.sh platforma TEAM- LMS. Institucioni administron dokumentacion në lidhje me trajnimet e zhvilluara.</p> <p><i>Evidenca nr.3.2 “Strategjia e kërkimit shkencor UET 2021-2025”, Evidenca nr.3.1 “Strategjia e kërkimit shkencor UET 2017-2020”, Evidenca nr.46.4 “Video trajnime mbi sistemin TEAMS-LMS”, Evidenca nr.33 “Të dhëna për trajnime profesionale për stafin dhe studentët”.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni dëshmon një angazhim të përshtatshëm të burimeve njerëzore për zhvillimin e programit në përputhje me objektivat e tij. Institucioni administron një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program në të tre vitet akademike si dhe të personave përgjegjës për organizimin e programit të studimit. Angazhimi i personelit akademik pasqyrohet në sillabusin e lëndëve si dhe në ngarkesën mësimore dhe është në përputhje me realizimin e objektivave të programit të studimit.</p>



	<i>Evidenca nr.11 "Rregullore për burimet njërezore", Evidenca nr.44.1.442, "Format Dosje Stafë Akademik", Evidenca nr. 19.1 "Formati I Syllabusit".</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi IV.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>Nga dokumentacioni si dhe vizita pranë Institucionit, rezulton se infrastruktura dhe mjediset mësimore janë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë së mësimdhënies në përputhje me natyrën dhe qëllimet e programit. Aktualisht institucioni e ushtron aktivitetin e tij akademik në një godinë me sipërfaqe 7.545 m<sup>2</sup>, e cila përbëhet nga ambjentet mësimore (salla leksioni dhe seminaresh). Në këtë sipërfaqe gjenden 15 salla leksioni dhe 13 sallat seminaresh. Ambientet plotësojnë kriteret e sipërfaqës dhe kanë hapsira të përshtatshme. Sallat e leksioneve kanë një kapacitet prej 1138 vende, ndërsa sallat e seminareve 353 vende. Këto salla janë të pajisura me mjetet dhe kushtet nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të mësimdhënies. Përveç sallave të leksioneve dhe seminareve ka edhe laborator informatike të paisur me kompjutera të cilat mund të përdoren nga studentët.</p> <p><i>Evidenca nr.42 &amp; 42.1 "Infrastruktura në funksion të programeve të studimit".</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	<p>Institucioni disponon klasa, zyra, e mjedise të tjera me pajisje të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimit. Mjediset mësimore janë të pajisura me mjetet e duhura didaktike dhe elektronike. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me videoprojektor për të realizuar një proces sa më cilësor të mësimdhënies. Stafë akademik e zhvillon procesin mësimor duke përdorur mjetet audiovizive të instaluar në sallat mësimore. Këto mjete mund të përdoren edhe nga studentët për realizimin e prezantimeve apo detyrave të kursit.</p> <p><i>Evidenca nr.42 &amp; 42.1 "Infrastruktura në funksion të programeve të studimit".</i></p>



<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor “Juridik i përgjithshëm” nuk ka parashikuar orë lobaratori (sipas RVB-së). Megjithatë pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit. Nga vëzhgimi në institucion u konstatua paisja e sallave të leksioneve me mjete në funksion të teknikave të reja të mësimdhënies si p.sh projektor, poëer point etj. Të gjitha mjediset mësimore mbuloohen me sistemin e wi-fi.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni ka në përdorim 4 laborator të informatikës si dhe një sallë interneti. Sallat e laboratorëve për shkak të specifikës së programit Bachelor “Juridik i Përgjithshëm”.nuk i dedikohen specifikisht këtij program.</p> <p><i>Evidenca nr.42.1 “Infrastruktura në funksion të programeve të studimit”.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Për të mundësuar zhvillimin e praktikës profesionale në kushte optimale, si dhe në mjediset të mjaftueshëm dhe të përshtatshme, institucioni ka lidhur një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me studio ligjore si dhe institucione publike dhe private, si Bashkia Tiranë, INSTAT etj. Vendi ku zhvillohet praktika përcaktohet nga institucioni bazuar edhe në marrëveshjet për zhvillimin e praktikës. Gjatë periudhës së praktikës një herë në jave organizohen leksione të hapura në mjediset e Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare. Mjediset e këtij fakulteti janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e këtyre veprimtarive.</p> <p><i>Evidenca nr.32 “Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese”. Evidenca nr.32.1 Dokumenti B.J “Mbi praktikën profesionale”.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.4</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedisë mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedisë të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit si dhe nga vëzhgimi në institucion rezulton se në mjediset e Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare ku zhvillohet programi i studimit është ngritur dhe funksionon biblioteka e aksesueshme për stafin akademik dhe studentët. Biblioteka mund të aksesohet në kushte të barabarta nga të gjithë studentët e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca nr.42 &amp; 42.1 "Infrastruktura në funksion të programeve të studimit".</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka disponon literaturë edhe në funksion të programit të studimit. Në tërësinë e teksteve që janë pjesë e fondit fizik të bibliotekës dedikuar këtij program studimi, përfshihet si literaturë në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhë të huaj. Tekstet dhe materialet e tjera akademike në gjuhë të huaj dhe shqipe aksesohen elektronikisht në sistemin e bibliotekave on-line. Siç ka rezultuar edhe nga Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, GVJ gjykon gjithashtu <i>se fondi fizik i bibliotekës nuk është në kapacitet e duhura dhe duhet të pasurohet më tej me literaturë bashkëkohore në mbështetje të programit të studimit.</i></p> <p><i>Evidenca nr.45 "Inventar i teksteve në bibliotekë për fushën e programeve të studimit". Evidenca nr.0. "RVB-BA_Juridik I Përgjithshëm."</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Përtej fondit fizik të bibliotekës, në dispozicion të studentëve ishte edhe libraria elektronike. Në funksion të procesit mësimor dhe të këtij programi studimi institucioni ka mundësuar akses në disa biblioteka elektronike si Sage, Ebsco dhe Questia ku studentët mund të aksesojnë literaturë në gjuhë shqipe apo të huaj. Njëkohësisht biblioteka është pjesë e sistemit COBISS.Net të bibliotekave on-line. Fondi i bibliotekës që mundësohet nga këto burime për Fakultetin e Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare është 2835 libra. Mundësia e aksesit në bibliotekë ishte pa pagesë.</p> <p><i>Evidenca nr.42 &amp; 42.1 "Infrastruktura në funksion të programeve të studimit", Evidenca nr.45.1 "Mbi funksionimin e bibliotekës".</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka ka një sistem kompjuterik të regjistrimit të librave dhe kërkimit të literaturës. Njëkohësisht ka akses në disa platforma on-line të bibliotekave si dhe sisteme teknologjike si wi-fi të cilat mundësojnë përdorimin nga studentët.</p> <p><i>Evidenca nr.42 &amp; 42.1 "Infrastruktura në funksion të programeve të studimit".</i></p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Në aktet rregullatore të institucionit rezulton se pasurimi i fondit ekzistues të bibliotekës bëhet bazuar në kërkesat që përcillen nga njëria bazë përgjegjëse për këtë program studimi në përputhje me nevojat akademike e shkencore të personelit akademik. Përditësimi i literaturës mund të inicohet edhe nga Përgjegjësi i Bibliotekës, i cili në kuadrin e përgjegjësive të tij, ndjek rregullisht botimet e reja dhe ia propozon Departamentit. <i>Evidenca nr.45.1 Dokumenti E-IV "Mbi funksionimin e bibliotekës".</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Referuar akteve rregullatore, shërbimi në bibliotekë ofrohet në gjashtë ditë të javës (nga e hëna në të shtunë). Orari i shërbimit të Bibliotekës për ditët e hënë - e premte është 9:00 dhe për ditën e shtunë 20:00 dhe 10:00 – 17:00. Gjatë këtij orari studentët mund të konsultojnë literaturën që lidhet me programin e studimit ose sistemin e bibliotekës on-line. Nga vizata në mjediset e bibliotekës si dhe shqyrtimi i numrit të kartelave të anëtarësimit, u konstatua se numri i studentëve të abonuar në bibliotekë nuk ishte në nivele të kënaqshme.</p> <p><i>GVJ rekomandon se Institucioni duhet të nxisë më tej ndërgjegjësimin e studentëve në raport me qasjen e tyre në përdorimin e bibliotekës.</i></p> <p><i>Evidenca nr.45.1 Dokumenti E-IV "Mbi funksionimin e bibliotekës", Evidenca nr.45.2 E_IV_2 "Formular për pasurimin e literaturës në bibliotekë". Evidenca nr.45.3 "Shembull-procedure- blerje literature".</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X	

<p><b>Standardi IV.5</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në</p>	<p>Institucioni ka krijuar një sistem të informatizuar, sistemin UMIS me anë të të cilit mundëson menaxhimin me efiaksitet të informacionit. Ky sistem siguron administrimin e të dhënave që lidhen me studentët që nga momeneti i regjistrimit deri në diplomim. Të dhënat e pasqyrura në këtë sistem lidhen me të dhënat personale si dhe vlerësimet dhe mbarëvajtjen gjatë viteve akademike. Informacioni administrohet gjithashtu</p>



<p>diplomim në programin e studimit.</p>	<p>pranë Sekretarisë Mësimore. Nga vizita pranë Sekretarisë Mësimore u konstatua se sekretaria e administron informacionin si nëpërmjet përdorimit të plotformës elektronike ashtu edhe në format shkresor.</p> <p><i>Evidenca nr.46 "Manual i përdoruesit të sistemit UMIS".</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Administrimi i dokumentacionit për personelin akademik, ndihmës akademik dhe atë administrativ realizohet kryesisht nga Zyra e Personelit. Pranë kësaj zyre administrohen dosjet e personelit me të dhënat përkatëse. Gjatë vizitës në institucion nga verifikimi i dy dosjeve të personelit akademik u konstatua se këto dosje përmbajnë të dhëna të detajuara, përfshirë edhe përditësimet në lidhje me kualifikimin shkencor.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni përdor disa platforma për menaxhimin e informacionit që mundësojnë akses të dedikuar si për personelin akademik ashtu edhe për studentët e përfshirë në program. Platforma UMIS pasqyron të dhëna që lidhen me mbarëvajtjen e studimeve që nga regjistrimi deri në diplomim. Këto të dhëna shërbëjnë dhe për hartimin e raporteve statistikave. Platforma UET LMS i dedikohet bashkëveprimt midis studentëve dhe pedagogëve. Përdorimi i platformës mundëson marrjen e informacionit mbi sillabuset e lëndëve, programet mësimore, leksionet apo materiale të tjera të përcjella nga pedagogët si dhe aspekte që lidhen me sistemin e vlerësimit dhe angazhimin në lëndët përkatëse.</p> <p><i>Evidenca nr.46 "Manual i përdoruesit të sistemit UMIS", Evidenca nr.46.3 "UET LMS Guide për studentët", Evidenca nr.46.2 "UET LMS Guide per pedagogun", Evidenca nr. 9 Dokumenti E.I "Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore".</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Platformat që përdoren për shkëmbimin e informacionit janë pjesë e sistemeve të integruara të menxhimit që mundësojnë marrjen e informacionit në kohë reale dhe komunikimin ndërmjet personelit akademik, atij administrativ dhe studentëve. Këto platforma lehtësojnë komunikimin pasi çdo kërkesë për informacion si dhe aksesin ndaj këtij informacioni mundësohet në sistemin on-line të platformave. Aksesin në informacion si dhe komunikimi mund të realizohet edhe me përdorimin e postës elektronike, nëpërmjet adresave zyrtare të emailit.</p> <p><i>Evidenca nr.46 "Manual i përdoruesit të sistemit UMIS", Evidenca nr.46.3 "UET LMS Guide për studentët", Evidenca nr.46.2 "UET LMS Guide per pedagogun".</i></p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Platformat që përdoren për komunikim dhe shkëmbim informacionit mund të monitorohen në çdo kohë pasi hedhja e çdo të dhënë lë gjurme elektronike. Kjo mundëson marrjen e çdo informacioni të nevojshëm për qëllime monitorimi ose qëllime të tjera që lidhen me mbarëvajtjen dhe administrimin e procesit mësimor në këtë program studimi.</p> <p><i>Evidenca nr. 9 Dokumti E.I "Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore".</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Në faqen zyrtare të UET pasqyrohen në mënyrë të detajuar një sërë aspektesh mbi organizmin e programeve të studimeve që ofron institucioni. Pjesë e përmbajtjes së kësaj faqeje janë edhe të dhënat për stafin akademik, aktivitetet shkencore, shërbimet ndaj studentit etj. Informacionit në këtë faqe publikohen përveç gjuhës shqipe, edhe në gjuhën angleze.</p> <p><i>Faqja zyrtare ( <a href="http://www.uet.edu.al/reth/uet/">ëëë.uet.edu.al/reth/uet/</a>).</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.6</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Institucioni ka hartuar raporte financiare mbi shpenzimet financiare për studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor në Juridik i Përgjithshëm ku pasqyrohen të dhëna mbi koston për student sipas viteve akademike. Ndonëse jo referuar specifikisht këtij program studimi, institucioni ka hartuar plane financiare që i referohen ndarjes së burimeve financiare me qëllim mbarëvajtjen financiare në nivel institucional.</p> <p><i>Evidenca nr.18.1 "Të dhëna mbi koston për student", Evidenca nr.50.1-50.3 "Pasqyrat financiare me shënime".</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet</p>	<p>Planet e financimit hartohen për çdo viti buxhetor. Raportet financiare, përfshirë edhe planet e financimit janë hartuar në rang institucional referuar specifikës së ushtrimit të aktivitetit të institucionit në formatin e European Education Initiative sh.p.k. Në planet e financimit pasqyrohen detaje që i referohen ndarjes së burimeve financiare në formën e shpenzimeve dhe</p>



<p>operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>të të ardhurave. Pasqyrimi i këyre të dhënave nuk është i kategorizuar sipas programeve që ofron institucioni.</p> <p><i>Si i tillë nuk i referohet në mënyrë specifike zërave në shërbim të realizimit të programit të studimit Bachelor në "Juridik i Përgjithshëm".</i></p> <p>Në pasqyrat financiare të vitit 2018 janë specifikuar shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës.</p> <p><i>Evidenca nr.50.1-50.3 "Pasqyrat financiare me shënime".</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Institucioni zbaton detyrimet që lidhen me monitorimin e situatës financiare, auditimin dhe raportimin. Referuar dokumentacionit, (<i>raportet e auditimit</i>) institucioni realizon auditim të përvitshëm të pasqyrave financiare duke mundësuar në këtë mënyrë transparencën financiare. Auditimi realizohet nga auditues ligjor të pavarur. Në raportet e auditimit pasqyrohet opinioni i tyre mbi transparencën financiare si dhe pasqyrimin e të dhënave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.</p> <p><i>Evidenca nr.50.4-50.6 "Raportet e e auditimit".</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Institucioni dokumenton në mënyrë sistematike gjendjen e tij financiare. Referuar dokumentacionit, Institucioni çdo vit harton dhe dokumenton raportin financiar mbi gjendjen financiare të tij, kontabilizimin e shpenzimeve të kryera dhe të ardhurave të gjeneruara. Njëkohësisht, në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, i nënshtrohet procedurave të auditimit të pasqyrimit të të dhënave financiare sipas standarteve të kërkuara.</p> <p><i>Evidenca nr.50.1-50.3 "Pasqyrat financiare me shënime", Evidenca nr.50 "Të ardhura dhe financime të ndryshme", Evidenca nr.50.4-50.6 "Raportet e auditimit".</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës</p>	<p>Institucioni ka dokumentuar veprimtarinë e tij financiare ku pasqyrohet mënyra se si institucioni administron astetet dhe burimet si dhe rezultatet financiare të veprimtarisë ushtrimore vjetore. Raportet vjetore dhe pasqyrat financiare të tyre i janë nënshtuar auditimit nga jashtë, i cili ka certifikuar shifrat e paraqitura dhe përputhshmërinë e tyre me ligjin.</p>



financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	<p>Ngritja e strukturave të tilla si Bordi i Administrimit apo Administratori me kompetenca në fushën e mbarëvajtjes dhe administrimit financiar është një komponent pozitiv në drejtim të procesit të administrimit të financave.</p> <p><i>Raportimi i veprimtarisë financiare është paraqitur si një i tërë dhe nuk mund të nxirren përfundime për qëndrueshmërinë financiare të programeve të veçanta.</i></p> <p><i>Evidenca nr.50.1-50.3 "Pasqyrat financiare me shënime", Evidenca nr.50 "Të ardhura dhe financime të ndryshme", Evidenca nr.2 "Statuti I UET".</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Institucioni zbaton legjislacionin në fuqi lidhur me politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Për këtë qëllim janë hartuar nga institucioni edhe aktet rregullatore që prashikojnë politika dhe procedura që i referohen ecurisë së studentit që nga momenti i regjstrimit deri në diplomim.</p> <p><i>Evidenca nr.5 "Rregullore e UET", Evidenca nr. 7 "Rregullore mësimore BA Juridik i Përgjithshëm", Evidenca nr.2 "Statuti I UET".</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe	Rregullime specifike që mundësojnë barazinë në ushtrimin e të drejtave të studentëve parashikohen në mënyrë të shprehur në aktet rregullatore të institucionit. Respektimi i kriterëve dhe procedurave në përputhje me rregullimet ligjore gjatë gjithë procesit akademik, mundëson respektimin e parimit të barazisë dhe garantimit të të drejtave për të gjithë kandidatët



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Aktet rregullatore të institucionit përmbajnë rregullime të detajura mbi kriteret e ecurisë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim. Për këtë qëllim është hartuar një rregullore e posaçme për këtë program e cila parashikon procedura dhe kriteret të detajuara të përparimit akademik të tilla si: masën e frekuencimit të procesit mësimor në auditor (leksione, seminare), e cila është në masën 60%, pikët e nevojshme për vlerësimin kalues në secilën lëndë etj. <i>Evidenca 7 "Rregullore e programit të studimit BA Juridik I Përgjithshëm".</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Studentët njihen me procedurat dhe kuadrin rregullator të programit mësimor që në momentin e parë të regjistrimit. Kriteret dhe procedurat e transferimit dhe ekuivalentimit të lëndëve, janë të përcaktuara në rregulloren e institucionit dhe atë të këtij programi të studimi. Informacioni është lehtësisht i aksesueshëm edhe pranë Sekretarisë Mësimore. GVJ gjatë vizitës në institucion shqyrtoi disa dosje transferimesh dhe konstatoi korrektësi në administrimin e dosjeve të shqyrtuara.  <i>Evidenca nr.5 "Rregullorja e UET-së"; Evidenca nr.7 "Rregullorja e programit të studimit BA Juridik i Përgjithshëm"; Evidencanr.28 "Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve".</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në fillim të çdo semesri, studentët informohen nga pedagogët mbi përmbajtjen dhe komponentët e secilit nga syllabuset. Programet e lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm mbi mënyrën e vlerësimit të dijeve, si dhe komponentët e vlerësimit. Aksesimi i informacionit mundësohet edhe nëpërmjet sistemit LMS, përmes të cilit studentët aksesojnë programet e lëndëve, procedurat dhe rezultatet e vlerësimit.  <i>Evidenca nr.5 "Rregullorja e UET-së"; Evidenca nr.7 "Rregullorja e programit të studimit BA Juridik i Përgjithshëm"; Evidenca nr.14</i>



studentët e programit të studimit.	si dhe studentët e përfshirë në program. <i>Evidenca nr.5 "Rregullore e UET".</i>
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Procedurat dhe kriteret e përdorura për përzgjedhjen, vijimin e studimeve, vlerësimin e studimeve apo transferimeve janë të qarta dhe të kuptueshme. Këto kritere u bëhen të njohura të interesuarve apo kandidatëve për student në përputhje me procedurat e parashikura në aktet rregullatore. Informacioni i nevojshëm mund të aksesohet lehtësisht edhe pranë sekretarisë mësimore. Institucioni publikon informacion edhe në faqen e tij zyrtare.  <i>Evidenca nr.5 "Rregullore e UET", Evidenca nr. 7 "Rregullore e programit të studimit BA Juridik I Përgjithshëm", Evidenca nr. 28 Dokumenti D.II "Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin", Evidenca 14.1 "Plani mësimor i programit".</i>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve, kuotat si dhe procedurat e regjistrimit publikohen dhe u vihen në dispozicion të interesuarve përpara fillimit të vitit akademik. Përveç kritereve me karakter të përgjithshëm, kandidatët pranohen në këtë program në përputhje me kapacitetet e institucionit dhe sipas kritereve specifike që propozohen nga Departamenti dhe miratohen nga Senati Akademik.  <i>Evidenca 7 "Rregullore e programit të studimit BA Juridik I Përgjithshëm".</i>
<b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Për pranimet në këtë program studimi Institucioni zbaton kriteret e ligjit nr. 80/2015 Për arsimin e lartë" si dhe standartet shtetërore. Institucioni në aktet rregullatore ka sanksionuar kriteret e përgjithshme të pranimit për këtë program studimi. Njohja e një diplome të lëshuar nga institucione të huaja me kushtin e kuivalentimit pranë instancave përgjegjëse, mundëson regjistrimin e studentëve të huaj. Në këtë program studimi nuk rezultojnë të regjistruara studentë të tillë. <i>Evidenca 7 "Regullore e programit të studimit BA Juridik I Përgjithshëm".</i>
<b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Përpara çdo viti akademik institucioni zhvillon aktivitete sensibilizuese dhe nxitëse për përfshirjen në këtë program, ku të interesuarit informohen edhe me kriteret e programin e studimit. Kriteret e pranimit publikohen on-line në faqen zyrtre të UET. Njëkohësisht informacioni në lidhje me programet e studimit mund të aksesohet edhe në formën e broshurave informuese.  <i>Evidenca nr.51 "Politikat a marketingut të programit të studimit", Evidenca nr.48 Dokumenti E.V"Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET on- line".</i>



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Studentët e këtij programi mund të sigurojnë informacion nga një sërë burimesh si Departamenti, Sekretaria Mësimore, Zyra e Kujdesit ndaj Studentit etj. Departamenti i Shkencave Juridike si njësi bazë përgjegjëse për zbatimin e programin të studimit ka në përbërje të gjitha kapacitetet njerëzore për tu mundësuar studentëve informacionin e nevojshëm mbi komponentët e programit. Njëkohësisht Zyra e Kujdesit ndaj Studentit në kuadrin e kompetencave të veta, siguron informacionin e nevojshëm për studentët.</p> <p><i>Evidenca nr.12 Dokumneti E-VII "Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit"; Evidenca nr.36 "Vendim për emërimin e kordinatorit të programit të studimit", Evidenca nr.6 Dokumenti E.I "Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore".</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Programi mësimor i këtij cikli studimi përmban informacione të detajuara mbi modulet, lëndët dhe veprimtaritë formuese. Ky informacion iu jepet studentëve që në momentet e para të kontaktit me institucionin. Institucioni i publikon informacionet në lidhje me programet e studimit që ofron edhe në faqen zyrtare të tij. Gjithashtu nëpërmjet sistemit LMS studentët mund të aksesojnë dokumentacion në kohë reale mbi përmbajtjen dhe komponentët e lëndëve dhe moduleve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni ka ngritur struktura që mundësojnë mbështetjen dhe orientimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit dhe tregut të punës. Pranë Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare si njësi kryesore është ngritur Zyra e Karrierës e cila kujdeset për informimin e studentëve për mundësitë e punësimit. Institucioni ka krijuar Bordin e Tregut të Punës i cili ka në përbërje ekspertë të jashtëm, apo përfaqësues të alumni. Ky Bord mbështet njësinë bazë për të krijuar lidhje të vazhdueshme me tregun e punës dhe për të përmirësuar kurikulat në përshtatje edhe me nevojat e punësimit. Orientimit drejt tregut të punës i shërbejnë edhe organizimi i panairëve të punës dhe aktiviteteve të ngjashme.</p> <p><i>Evidenca nr.12 Dokumneti E-VII "Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit"; Evidenca nr.12.1 "Bordi i Tregut të Punës", "Evidenca nr.12.2 Poster Panairi I Punës 2018-2019-2020".</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor,</p>	<p>Studentët marrin informacion të detajuar që në fazën e parë të kontaktit me institucionin, në momentin e regjistrimit. Njëkohësisht pedagogët e departamentit luajnë një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve mbi detajet e</p>



	<i>"Kurrikula e Programit BA Juridik I Përgjithshëm"; Evidenca 14.3 "Plani mësimor i programit BA Juridik I Përgjithshëm".</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	<p>Aktet rregullatore të institucionit kanë parashikur rregullime mbi kriteret dhe procedurat e diplomimit. Format e mbrojtjes së diplomës janë me provim diplome ose me përgatitjen e një teme diplome. Të drejtën për të punuar një temë diplome e kanë studentët që kanë mestaren e studimeve të paktën 7.5. Njësia përgjegjëse e këtij programi studimi orienton studentët mbi kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës si dhe i asiston ata në këtë proces. Pedagogët e caktuar nga departamenti udhëzojnë studentët për përgatitjen e temave të diplomës. Rregullime në këtë drejtim janë përcaktura në mënyrë specifike edhe në dokumentin përkatës që lidhet me punimin e temave të diplomës.</p> <p><i>Evidenca nr.5 "Rregullorja e UET-së"; Evidenca nr.7 "Rregullorja e programit të studimit BA Juridik i Përgjithshëm"; Evidenca nr. 10 Dokumenti B.II "Mbi punimin e diplomës dhe dizertacionit".</i></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>Institucioni përpara fillimit të çdo viti akademik realizon aktivitete informuese në qytete të ndryshme të vendit me fokus grup maturantët me qëllim njohjen me programet e studimit. Takime të tilla informuese zhvillohen edhe në mjediset e institucionit ku shpërndahen edhe fletëpalosje për të interesuarit mbi të dhënat e programit të studimit. Këto informacione publikohen gjithashtu edhe në rrjetet sociale, media si dhe në faqen zyrtare të institucionit. Forma të tjera të informimit janë edhe Open Days ku të interesuarit mund të vizitojnë institucionin si dhe Java e Orientimit për studentët e rinj. Në këto veprimtari një rol të rëndësishëm luan edhe njësia bazë.</p> <p><i>Evidenca nr.51 "Politikat a marketingut të programit të studimit", Evidenca nr.48 Dokumenti E.V "Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET on- line", Evidenca nr.10.1-10.4 "Kalendari akademik", Evidenca nr.38 "Analiza e Departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave".</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit**



logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	<p>organizimit të procesit mësimor që në orën e parë të prezantimit. Kordinatori i Departamentit dhe Zyra e Kujdesit ndaj Studentit luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Çdo informacion i nevojshëm mbi zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet mund t'u jepen studentëve çdo herë që kërkojnë të informohen.</p> <p><i>Evidenca nr.12 Dokumenti E-VII "Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit"; Evidenca nr.36 "Vendim për emërimin e kordinatorit të programit të studimit".</i></p>			
<p><b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Aksesi në informacion mbi këtë program studimi mundësohet nëpërmjet një sërë sistemesh të shpërndarjes së informacionit. Platforma UET LMS e cila përdoret si nga stafi akademik ashtu dhe studentët, mundëson marrjen e informacionit në kohë reale mbi aspekte që lidhen me mbarëvajtjen e procesit mësimor. Sistemi UMIS mundëson informimin e studentëve mbi provimet, vlerësimin, orarin, infrastrukturën apo komponentë të tjerë të lidhur me programin. Për aksesimin e platformave studentët paisen me një adresë zyrtare emaili. Gjithashtu, informacioni mbi programin e studimit mund të aksesohet faqen zyrtare të Institucionit. (<a href="http://www.uet.edu.al">www.uet.edu.al</a>).</p> <p><i>Evidenca nr.46 "Manual i përdoruesit të sistemit UMIS", Evidenca nr.46.3 "UET LMS Guide për studentët", Evidenca nr.46.2 "UET LMS Guide per pedagogun".</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>Institucioni disponon të dhëna statistikore mbi numrin e studentëve që ndjekin këtë program studimi si dhe ata të diplomuar. Ky dokumentacion administrohet pranë Sekretarisë mësimore. Sipas të dhënave statistikore në këtë program studimi në vitin akademik 2018-2019 janë diplomuar gjithsej 147 studentë, në vitin akademik 2019-2020, 100 studentë dhe në vitin akademik 2020-2021, 60 studentë.</p>



	<i>"Evidenca nr.27 "Cilësia në hyrje dhe dalje BA Juridik i përgjithshëm".</i>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Si struktura përgjegjëse, Sekretaria Mësimore administron të dhënat që lidhen me çdo vit akademik mbi studentët e regjistruar në këtë program, numrin e studentëve që ndjekin këtë program si dhe tërheqjet nga programi apo mospërfundimin e tij. Pranë sekretarisë depozitohet gjithashtu dokumentacioni i personelit akademik mbi vijueshmërinë e procesit mësimor, frekuentimin si dhe vlerësimin e provimeve. Ky dokumentacion shërben si bazë për përpunimin e të dhënave statistikore. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe vizitës së GVJ-së, në sekretarinë mësimore u konstatua se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për tre vitet e fundit akademike ishte:</p> <p>Viti 2017-2018 156 studentë gjithsej;  Viti 2018-2019 76 studentë gjithsej;  Viti 2019-2020 47 studentë gjithsej;</p> <p>Mbas vitit akademik 2019-2020, nuk janë regjistruar më studentë në këtë program studimi, pasi është riorganizuar në program studimi të ciklit të dytë master i shkencave i integruar.</p> <p><i>"Evidenca nr.27 "Cilësia në hyrje dhe dalje BA Juridik I përgjithshëm".</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Në të njëjtën formë sa më sipër, institucioni për këtë program studimi administron të dhëna mbi ecurinë akademike të studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomim. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi notën mestare në hyrje dhe në dalje, mund të konkludohet se për periudhën 2018-2021, nota mesatarja e hyrjes në programin e studimit varion nga 7.27-8.50. Për sa i takon mesatares së daljes, ajo është pothuajse konstante, nga 7.09-7.14. Vlera më e lartë e mesatares i referohet vitit 2018-2019 dhe është 9.98. Vlera më e ulët i referohet të njëjtit vit dhe është 5.20. <i>"Evidenca nr.27 "Cilësia në hyrje dhe dalje BA Juridik I përgjithshëm".</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistikore të studentëve ruhen dhe administrohen nga Sekretaria Mësimore. Administrimi i të dhënave në sekretari mundësohet në format elektronik nëpërmjet menaxhimit elektronik. Këto të dhëna ruhen gjithashtu edhe në formatin dokumentar në formën e regjistrave apo procesverbaleve të notave. Format e administrimit garantojnë sigurinë e të dhënave dhe i bëjnë ato lehtësisht të aksesueshme.</p>



	<i>Evidenca nr.6 Dokumenti E.I "Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore".</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>UET analizon profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve nëpërmjet notës mesatare si dhe nxjerr rezultate mbi cilësinë dhe kalueshmërinë për këtë program studimi. UET përmes strukturave të dedikuara mundëson kontaktet me të diplomuarit edhe pas përfundimit të programit me qëllim ndjekjen në vijueshmëri të punësimit të tyre. Referuar statistikave të diplomimit dhe punësimit, për vitin akademik 2018-2019 janë diplomuar në këtë program 147 studentë prej të cilëve në një shkallë gjurmimi prej 55% janë punësuar 17 studentë, me një përqindje punësimi prej 12%. Për vitin akademik 2019-2020 janë diplomuar 100 studentë, prej të cilëve në një shkallë gjurmimi prej 55% janë punësuar 10 studentë, me një përqindje punësimi prej 10%. Të dhënat që i referohen vitit akademik 2020-2021, janë ende në proces përpunimi.</p> <p><i>Evidenca nr.27 "Cilësia në hyrje dhe dalje BA Juridik i përgjithshëm". Evidenca nr. 29 "Monitorim i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre".</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	<p>Referuar akteve rregullatore të institucionit, konkludohet se UET ka mundësuar përfshirjen dhe përfaqësimin e studentëve në një sërë strukturash përfaqësuese si Senati Akadamiq i UET, Këshilli i Etikës, dhe KSBC. Njëkohësisht është ngritur dhe funksionon Këshilli i Studentëve si një organ përfaqësues i interesave të tyre.</p> <p><i>Evidenca nr.2 "Statuti i UET", Evidenca nr.30 "Të dhëna për individët e përfshirë në KSBC".</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose	Pjesëmarrja e studentëve në organet përfaqësuese të UET mundëson një përfaqësim real të interesave të tyre në këto organe dhe përfshirjen në procesin e vendimmarrjes.



<p>përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Institucioni aplikon dhe procesin e vlerësimit të procesit të mësimdhënies dhe stafit akademik nëpërmjet pyetësorëve të studentëve, duke mundësuar marrjen e mendimeve dhe sugjerimeve të tyre. Gjithashtu, Departamenti mundëson përfshirjen e studentëve në vendimmarrje nëpërmjet mbledhjeve të hapura me pjesëmarrjen e studentëve të cilat zhvillohen një herë në muaj.</p> <p><i>Evidenca nr.5 "Rregullore e UET", Evidenca nr.2 "Statuti I UET", Evidenca nr.41 G-I-12-1 "Formular I vlerësimit të pedagogut nga studenti".</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Programi mësimor BA në Juridik i përgjithshëm ka një shpërndarje të ekuilibruar të lëndëve në semesra dhe ngarkeses në kredite. Në hartimin e programit të studimit është marrë në konsideratë ngarkesa akademike e studentëve. Strukturimi i programit me syllabuse dhe kredite nuk krijon vështirësi në procesin e transferimit të studimeve apo ekuivalentimit të lëndëve dhe krediteve. Nga verifikimi në sekretari rezultoi se nuk ka patur problematika në procesin e transferimeve pranë UET si dhe njohjes dhe ekuivalentimit të studimeve të mëparshme.</p> <p><i>Evidenca nr.5 "Rregullore e UET", Evidenca nr.14 "Kurrikula e programit BA Juridik I Përgjithshëm", Evidenca nr.52 "Procedura për ndryshimin e kurrikulës", Evidenca nr.28 Dokumneti D.II "Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve"</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Formularët e vlerësimit nga studentët, përmbajnë edhe elementë që lidhen me programin e studimit dhe programet e secilës lëndë. Kjo u mundëson studentëve të japin opinionet dhe kometetet e tyre mbi cilësinë e programit dhe sugjerojnë përmirësime. Këta pyetësore mund të bëhen objekt diskutimi dhe reflektimi në departament përfshirë edhe propozimet konkrete për përmirësimin e përmbajtjes së programeve mësimore. <i>Evidenca nr.41 G-I-12-1 "Formular I vlerësimit të pedagogut nga studenti", Evidenca nr.52 "Procedura për ndryshimin e kurrikulës"</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e</p>	<p>Rregullorja e Programit Bachelor "Juridik i Përgjithshëm" parashikon rregullime që mundësojnë transparencën në procesin e vlerësimit si dhe mundësinë e ankimimit ndaj rezultatit. Përpara hyrjes në provim, studentët janë njohur me vlerësimet e provimeve të pjesshme (për lëndët që i kanë parashikuar) si dhe vlerësimet e tjera gjatë semesrit. Rezultatet e provimit përfundimtar ju komunikohen studentëve edhe nëpërmjet platformës elektronike LMS.</p>



institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	<p>Studentët kanë mundësinë e ankimit në lidhje me rezultatin e vlerësimit. E drejta për ankimim ushtrohet fillimisht nëpërmjet ballafaqimit me pedagogun përgjegjës. Nëse studenti pretendon se kërkesa e tij nuk është zgjidhur, mund ti drejtohet nëpërmjet një kërkesë me shkrim Departamentit. Në këtë rast ngrihet një komision prej tre pedagogësh për vlerësimin e tezës, i cili jep vendimin përfundimtar. Pyetësorët e vëna në dispozicion nga Departamenti kanë elementë që lidhen me procesin e vlerësimit të dijeve, ku studentët mund të shprehin mendimin dhe sugjerimet e tyre në lidhje me këtë proces.</p> <p><i>Evidenca nr.5 "Rregullore e UET", Evidenca nr.41 G-I-12-1 "Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studenti".</i></p>
--	--

<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Standardi V.6**

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Akte rregullatore të institucionit parashikojnë procedura dhe struktura të dedikuara ndaj shërbimit dhe informimit të studentëve. Struktura të tilla janë Sekretaria Mësimore, Zyra e kujdesit ndaj studentit, Kordinatori pranë Departamentit, si dhe vetë Departamenti si njësi përgjegjëse për administrimin e procesit akademik. <i>"Evidenca nr.2 "Statuti i UET"</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	UET ka një sistem funksional të informimit, këshillimit dhe mbështetjes së studentëve gjatë gjithë procesit mesimor. Të gjitha strukturat të cilat e kanë këtë pjesë të kompetencave, si edhe ato të dedikura ndaj studentëve, koordinojnë veprimtaritë e tyre me qëllim asistimin e vazhdueshëm për çështje që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe	UET ka një sistem institucional të këshillimit të karrierës dhe orientimit në tregun e punës. Njësia kryesore në këtë drejtim është Zyra e Këshillimit të Karrierës si strukturë e posaçme për mbështetjen dhe orientimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit dhe tregut të punës. Bordi i Tregut të Punës



<p>periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>mbështet studentët për të krijuar lidhje të vazhdueshme me tregun e punës. Departamenti i Shkencave Juridike si njësi përgjegjëse ofron në mënyrë të vazhdueshme, mbështetje informim dhe orientim në lidhje me procesin mësimor dhe komponentë të tjerë të programit të studimit. Departamenti mbikqyr procesin e praktikës profesionale, udhëzon dhe orinton studentët në zhvillimin e praktikës në institucionet publike e private me të cilat UET ka lidhur marrëveshje.</p> <p><i>Evidenca nr.12 Dokumenti E-VII "Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit", Evidenca nr.32.1 Dokumenti B-I "Mbi praktikën profesionale".</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Institucioni mbledh dhe përpunon statistika në lidhje me shkallën e punësimit të studentëve që përfundojnë këtë program studimit. Kjo do të thotë që studenti ndiqet jo vetëm gjatë vazhdimësisë së programit por edhe pas përfundimit të tij. Ky proces realizohet jo vetëm nga Zyra e Karrierës, por edhe nëpërmjet strukturave dhe formave të tjera si UET ALUMNI. Nëpërmjet këtij sistemi synohet mbajtja e kontakteve të studentëve edhe pas diplomimit si dhe ndjekja e punësimit të tyre.</p> <p><i>Evidenca nr.27 "Cilësia në hyrje dhe dalje BA Juridik i përgjithshëm", Evidenca nr. 29 "Monitorim i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre".</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<p><b>Standardi VI.1</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Institucioni ka institucionalizuar Sistemin e Brendshëm të Cilësisë në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe aktet rregullatore të tij. Sigurimi i brendshëm i cilësisë është një nga objektivat strategjikë në nivel institucional. Për këtë qëllim janë hartuar strategji për sigurimin e cilësisë, plane veprimi si dhe manuale për sigurimin e cilësisë, të cilat parashikojnë objektiva dhe hapa konkret në drejtëm të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë hartuar nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB), referohet tek standartet shtetërore të cilësisë, duke siguruar në këtë mënyrë funksionimin e sistemit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në përshtatje me standartet e kërkuara.</p> <p><i>Evidenca nr.2 "Statuti i UET", Evidenca nr.38 "Strategjia për sigurimin e cilësisë", Evidenca nr.8 Dokumenti F.VII "Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë", Evidenca nr.30.1 "Plani i veprimit KSBC".</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni ka ngritur një sistem funksional të sigurimit të cilësisë nëpërmjet strukturave permanente për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Strukturat për sigurimin e cilësisë janë: Strukturat hierarkike dhe organizative të UET, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC). KSBC si një nga strukturat kyesore të sigurimit të cilësisë mbikqyr standartet e brendshme të cilësisë, propozon ndryshime në drejtim të rritjes së cilësisë, si dhe vlerëson efektivitetin evprimitarive mësimore-kërkimore të institucionit, mundëson mbledhjen e rezultateve nga instrumentat e vlerësimit të cilësisë. Këto rezultate i behën të njohura strukturave përkatëse. Procesi i vlerësimit të cilësisë mundësohet edhe përmes instrumenteve të tjerë sic janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- vetvlerësimi i stafit akademik;</li> <li>- vlerësimi i stafit akademik nga drejtuesit e njësive (dekani, përgjegjësi i departamentit);</li> <li>- vlerësimi nga studentët nëpërmjet pyetësorëve;</li> </ul> <p><i>Evidenca nr.2 "Statuti i UET", Evidenca nr.38 "Strategjia për sigurimin e cilësisë", Evidenca nr.8 Dokumenti F.VII "Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë", Evidenca nr.30.1 "Plani i veprimit të KSBC".</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes</p>	<p>Institucioni i është nënështruar në mënyrë periodike instrumentave të vlerësimit të jashtëm të cilësisë nëpërmjet procesit të akreditimit. Ai i është nënshtruar akreditimit instiucional, si dhe në mënyrë periodike akreditimit të programeve të studimit që ofron. Si pjesë e programeve të</p>



<p>proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>ofruara nga UET, programi i studimit Bachelor në “Juridik i Përgjithshëm” gjithashtu ka kaluar në procedurat e vlerësimit periodik të cilësisë. Ky program është akredituar fillimisht me Urdhërin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr.246, datë 24.07.2009. Me tej program është akredituar me Urdhërin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr.183, datë 19.04.2016.</p> <p><i>Evidenca nr.54.3-54.5 VBA Nr. 46 datë 05.07.2019 “Akreditimi periodic institucional”, Evidenca nr.54.6 UMAS Nr. 183 datë 19.04.2016 “Akreditim BA- Juridik I Përgjithshëm”.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjsteve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Sigurimi i cilësisë së programeve të studimit është një nga objektivat që i referohet Sistemit të Brendshëm të Cilësisë. Për këtë qëllim, Institucioni ka hartuar politika dhe ndjek procedura të sigurimit të cilësisë të programeve të studimit. Institucioni i pasqyron politikat e tij të sigurimit të cilësisë në dokumenta konkretë strategjikë si dhe i konkretizon në plane veprimi që kanë një sërë parashkimesh mbi monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë. Në nivel institucional organet drejtuese të institucionit, në kuadrin e kompetencave të tyre garantojnë zbatimin e politikave dhe strategjive që i referohen sigurimit të brendshëm të cilësisë. Njëkohësisht njësia bazë përgjegjëse, Departamenti i Shkencave Juridike, aplikon instrumente për realizimin e cilësisë së procesit mësimdhënies dhe programeve të studimit:</p> <p><i>Evidenca nr.38 “Strategjia për sigurimin e cilësisë”, Evidenca nr.8 Dokumenti F.VII “Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë”, Evidenca nr.30.1 “Plani i veprimit të KSBC, Evidenca nr.30.7 “Shpërndarja e relacionit të KSBC për syllabuset”.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.2</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e</p>	<p>Institucioni në kuadrin e monitorimit të cilësisë, angazhon strukturat kompetente në mbikqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit. Në nivel institucional, KSBC në kuadrin e kompetencave të monitorimit të cilësisë, vlerëson</p>



<p>programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>efikasitetin e veprimtarive mësimore si dhe propozon ndryshime në drejtim të përmirësimit të cilësisë. Aktualisht është ngritur dhe funksionon Zyra e Kurrikulave, një zyrë e posaçme e didikuar ndaj kurrikulës e cila mbikqyr përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. Departamenti si njësi bazë, luan rol thelbësor në rishikimin dhe përmirësimin e programit mësimor. Kërkesa për ndryshimet në kurrikulën e programit buron nga Departamenti pas konsultimit me zyrën e Kurrikulave për miratimin përfundimtar në Senatin Akademik të UET.</p> <p><i>Evidenca nr.30.7 "Shpërndarja e relacionit të KSBC për syllabuset". Evidenca nr.52 "Procedura për ndryshimin e kurrikulës (Aneks tabela 11)", Evidenca 30.3 "Strategjia për sigurimin e Brendshëm të Cilësisë".</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Procedurat për miratimin, mbikëqyrjen e programeve janë parashikuar në aktet regullatore të UET, ku janë përcaktura dhe kompetencat e strukturave përgjegjëse në këtë drejtim. Miratimi i programeve të studimit bëhet nga Senati Akademik, ndërsa inisiativa për ndryshime dhe përmirësime mund të vijë nga Departamenti si njësi përgjegjëse për zbatimin e programit. Përgjegjësi i departamentit miraton çdo fillim viti akademik syllabuset e lëndëve si dhe vlerëson propozimet e personelit akademik për përmirësimin dhe rinovimin e programeve në përputhje me risitë shkencore dhe literaturën e azhornuar. Mbikqyrja e programit të studimit mundësohet nëpërmjet proceseve të vlerësimit periodik në kuadrin e vlerësimit në tërësi të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca nr.2 "Statuti i UET", Evidenca nr.52 "Procedura për ndryshimin e kurrikulës (Aneks tabela 11)", Evidenca 30.3 "Strategjia për sigurimin e Brendshëm të Cilësisë".</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni zbaton procedura dhe instrumete për ndjekjen e vazhdueshme të programit të studimit, rishikimit dhe përditësimit të tij. Programet mësimore i nënshtrohen procesit të vlerësimit periodik. Një nga mekanizmat për mbikëqyrjen e cilësisë së programit të studimit, janë pyetësorët e studentëve nëpërmjet të cilëve merret mendimi i tyre mbi procesin mësimor si dhe programin e studimit. Këto pyetësorë bëhen çdo semesër duke mundësuar monitorimin periodik të cilësisë së programit. KSBC përcjell rezultate në strukturat përkatëse si dhe rekomandon masat e nevojshme. Rezultatet e anketimeve i përcillen edhe Departamentit i cili mund të reflektojë dhe propozimet për ndryshime.</p>



	<i>Evidenca nr.38 "Strategjia për sigurimin e cilësisë", Evidenca nr.30.7 "Shpërndarja e relacionit të KSBC për syllabuset".</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Rezultatet që vijnë nga procesi i vlerësimit të programit të studimit i bëhen të njohura Departamentit dhe stafit akademik nëpërmjet raporteve përmbledhëse. Raportet në lidhje me rezultatet e vlerësimit u adresohen edhe instancave të larta drejtuese të institucionit.  <i>Evidenca nr.38 "Strategjia për sigurimin e cilësisë", Evidenca nr.30.7 "Shpërndarja e relacionit të KSBC për syllabuset".</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Raportet e vlerësimit pasqyrojnë rezultatet e përputhshmërisë së programeve të studimit me standartet e cilësisë së UET, mangësitë, si dhe adresojnë rekomandimet për përmirësimin e cilësisë. <i>Evidenca nr.30.7 "Shpërndarja e relacionit të KSBC për syllabuset".</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Vlerësimi i programit të studimit bëhet në kuadrin e strukturave institucionale të vlerësimit të cilësisë. Struktura kryesore në këtë drejtim është KSBC. Në nivel të njësisë përgjegjëse vlerësimi periodik i programit realizohet nëpërmjet rezultateve të anketimeve të studentëve për secilën nga syllabuset përkatëse. Rezultatet e vlerësimit janë pjesë e vetvlerësimit institucional në kuadër të akreditimit apo proceseve të vetvlerësimit të brendshëm.  <i>Evidenca nr.30.7 "Shpërndarja e relacionit të KSBC për syllabuset", Evidenca nr.40 G-III-4-2 "Format I vlerësimit të pedagogut nga studentët".</i>
<b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës	Për vlerësimin e cilësisë së programit janë përdorur një sërë metodash në përshtatje me natyrën dhe specifikat e tij. Programi i është nënshtruar procesit të vlerësimit të brendshëm dhe është realizuar edhe Raporti i Vlerësimit të Brendshëm nga GVB. Në hartimin e këtij raporti GVB ka



<p>akademike të programit të studimit.</p>	<p>përdorur një sërë instrumentash për të vlerësuar ecurinë e programeve të studimit. Të dhënat e raportit përdoren edhe për dosjen e vetvlerësimit të institucionit. Këto të dhëna përdoren nga Departamenti apo struktura të tjera për efekt të analizave mbi efektshmërinë e programit.</p> <p><i>Evidenca nr.0 RVB-BA "Juridik i Përgjithshëm".</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Në kuadrin e Departamentit si njësia përgjegjëse, janë përdorur një sërë metodash dhe procedurash që i referohen mbarëvajtjes dhe cilësisë së programit të studimit. Pjesë e sistemit të vlerësimit të mbarëvajtjes së programit të studimit janë edhe vlerësimi i të nxënit dhe rezultatëve të studentëve nëpërmjet prezantimit në auditor, testimet paraprake dhe përfundimtare, si dhe vlerësimit të detyrave të kursit. Për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies janë përdorur metoda të drejtpërdrejta si vëzhgimi i zhvillimit të mësimit në auditor me pjesëmarrjen e kolegëve apo vizita nga Drejtuesi i Departamentit ose Dekani. Kryesisht metoda të tilla i referohen rasteve që lidhen me personelin akademik të kategorisë Lektor dhe Asistent Lektor.</p> <p><i>Evidenca nr.0 RVB-BA "Juridik i Përgjithshëm". Evidenca nr.7.2 Dokumenti A.IV "Sistemi i vlerësimit të studentëve", Evidenca nr.30.8 G.III.4.1 "Formular i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu".</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Në kuadrin e metodave të tërthorta të përdorura në procesin e vlerësimit të programit të studimit, është mundësuar tërheqja e mendimit të studentëve. Institucioni ka përdorur si metodologji vlerësimi anketimet e studentëve që japin rezultate në lidhje me vlerësimin e studentëve mbi programin e studimeve. Rezultatet e vlerësimit janë pjesë e raportit të GVB. Këto anketime i referohen studentëve që janë në vijim të programit të studimit. Institucioni ka përdorur si metodologji vlerësimi edhe vetvlerësimet e pedagogëve mbi performancën dhe mbarëvajtjen e programit të studimit. Nëpërmjet Rrjetit Alumni janë mundësuar aktivitete me studentët e diplomuar, por sondazhet duhet të jenë më përfaqësuese në mënyrë që konkluzionet të jenë më të qëndrueshme.</p> <p><i>Evidenca nr.40 G-III-4-2 "Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët", Evidenca nr.41 G-I-12-1 "Formular i vetvlerësimit të performancës së personalit akademik".</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>



**Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Metodat e përdorura në kuadrin e vlerësimit të programit kanë mundur përfshirjen e një sërë aktorësh si dhe aksesimin e kontributeve të tyre në vlerësimin e cilësisë së programit. Në vlerësimin e brendshëm të cilësisë, institucioni përfshin një sërë aktorësh të brendshëm, personelin akademik, ndihmës administrativ si dhe studentët. Për sa i takon aktorëve të jashtëm, ndonëse roli i tyre është më periferik, nëpërmjet formave të tilla si Bordi i Tregut të Punës, Marëveshtjet e bashkëpunimit me institucione publike dhe private, Rrjeti ALUMNI mundësohet edhe ndikimi i tyre në përmirësimin e vazhduar të cilësisë.</p> <p>Përfshirja e një eksperti të jashtëm në përbërjen e KSBC është një tjetër element në këtë drejtim. Institucioni ka mundur partneritetin në dy projekte të rëndësishme që i referohen sigurimit të brendshëm të cilësisë, projekti TEMPUS ENCHASE dhe ai Erasmus + QAIN AL.</p> <p><i>Evidenca nr.30.3 "Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë", Evidenca nr.30.4 "Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC". Evidenca nr.12.1 "Bordi i Tregut të Punës".</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Aktet regullatore të institucionit kanë parashikime të detajuara në lidhje me funksionet, kompetencat dhe rolin që do të luajë secila nga strukturat e angazhuara në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë të programit të studimit. Në këto akte janë përcaktuar edhe detyrat dhe përgjegjësitë e secilës nga strukturat në ushtrimin e kompetencave të tyre.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik,</p>	<p>Nga RVB dhe aktet regullatore të institucionit, evidentohet roli i Departamentit të Shkencave Juridike si njësi përgjegjëse kryesore për këtë program studimi, si dhe ai i personelit akademik dhe ndihmës akademik dhe administrativ, studentëve në vlerësimin e cilësisë së programit të studimit.</p>



ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	<i>Evidenca nr.0 RVB-BA "Juridik I Përgjithshëm.</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Nga takimet me personelin akademik dhe studentët e këtij programi nuk u konstatuan elementë të cënimit të integriteti akademik, pabarazisë apo diskriminimit në procesin e përfshirjes dhe aktivizimit të tyre në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit. Barazia dhe integriteti akademik i personalitetit akademik janë objekt i rregullimit nga normat e etikës. <i>Evidenca nr.16 A-II "Kodi I Etikës".</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë mundësohet edhe përfshirja e pedagogëve të jashtëm (PAK). Një pjesë e kësaj kategorie të përfshirë në programin e studimit ishin pjesë e takimit të zhvilluar nga GVJ me personelin akademik.  Në përbërjen e KSBC është edhe një ekspert i jashtëm. Bordi i Tregut të Punës jep gjithashtu ekspertizën e tij mbi cilësinë e programit. <i>Evidenca nr.30.4 "Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC". Evidenca nr.12.1 "Bordi I Tregut të Punës".</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Veprimtaritë e monitorimit që realizohen në kuadrin e procesit të vlerësimit pasqyrohen në formën e raporteve me konkluzionet përkatëse. Ato u bëhen të njohura strukturave drejtuese. Studentët marrin informacion nga Njësia Bazë në lidhje me problematikat që lidhen me mbarëvajtjen e programit të studimit. Për këtë qëllim një herë në muaj departamenti zhvillon mbledhje të hapura me pjesëmarrjen e studentëve ku diskutohen edhe problematika që i referohen cilësisë së programit të studimit. <i>Evidenca nr.30.1 "Plani i veprimit KSBC".</i>



<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Informacioni në lidhje me rezultatet e vlerësimeve që i referohen cilësisë së programit të studimit komunikohet nëpërmjet korespondencës shkresore. Rezultatet që dalin nga pyetësorët e studentëve dhe vlerësimet për personalin akademik nga Përgjegjësi i Departamentit, bëhen të njohura duke respektura etikën akademike dhe ruajtjen e të dhënave personale.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Të dhënat që evidentohen nga vlerësimi i brendshëm i cilësisë shërbejnë për identifikimin e problematikave të konstatuara si dhe për marrjen e masave për përmirësimin e mangësive të evidentuara. Këto masa pasqyrohen edhe në planet e veprimit të cilat hartohen në mënyrë periodike në varësi të nevojave për ndërhyrje dhe përmirësim. <i>Evidenca nr.30.1 "Plani i veprimit KSBC".</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVB dhe akteve rregulatore, Institucioni vlerëson impaktin e veprimtarive të realizuara në kuadrin e vlerësimit të cilësisë duke përfshirë në këtë proces një numër sa më të gjerë të strukturave të tij në nivel institucional KSBC, Zyra e Kurrkulës, Zyra e Standarteve dhe e Cilësisë, apo strukturash në nivel të njësisë përgjegjëse, si drejtuesi i departamentit, kordinatorët e programit etj. <i>Evidenca nr 2 "Statuti I UET". Evidenca nr.0 RVB BA "Juridik I Përgjithshëm".</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to. Përfshirja e studentëve në strukturat drejtuese të institucionit me përgjegjësi të drejtpërdrejtë në sigurimin e cilësisë si përbërja e KSBC apo Senatit Akademik është një tregues në këtë drejtim. Angazhimi në këtë drejtim, manifestohet edhe në publikimet në faqën zyrtare të institucionit, platformat elektronike apo rrjetet sociale të informacioneve mbi programin e studimit për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e përfshirjes në sigurimin e cilësisë së tij.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>



**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Juridik i Përgjithshëm”**

**a. Pikat e forta dhe afirmime:**

- 1. Kurrikula e programit mësimor.** Përmbajtja e kurrikulës së programit të studimit mundëson aftësimin e studentëve me njohuritë e nevojshme teorike në fushën juridike nëpërmjet harmonizimit të njohurive bazike të fushave të se drejtës private dhe publike me ato specifike dhe karakterizuese në përputhje me sfidat dhe nevojat e tregut të punës;
- 2. Angazhimi i përshtatshëm i burimeve njerëzore.** Angazhimi në shkallë optimale i burimeve njerëzore, si stafit akademik, ashtu edhe personelit ndihmës-administrativ, për zhvillimin e programit në përputhje me objektivat e tij;
- 3. Rekrutimi dhe promovimi i personelit akademik.** Adoptimi i procedurave transparente dhe në përputhje me kriteret ligjore të rekrutimit të personelit si dhe promovimit dhe vlerësimit të performancës së stafit akademik;
- 4. Vlerësimi dhe monitorimi i cilësisë.** Institucionalizimi i sistemit të brendshëm të cilësisë, nëpërmjet përdorimit të metodologjive e instrumentave matëse për vlerësimin e mbarëvajtjes dhe cilësisë së programit si dhe ngritjes së mekanizmave permanent dhe funksional të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë, si dhe strategjive të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë pranë institucionit;
- 5. Pjesëmarrja e studentëve në vlerësimin e cilësisë.** Përfshirjen e studentëve në procesin e vlerësimit të cilësisë nëpërmjet instrumentave që mundësojnë tërheqjen e mendimit të tyre si dhe përfaqësimit në strukturat e zgjedhura përgjegjëse për mbikqyrjen dhe vlerësimin e cilësisë;
- 6. Pjesëmarrja në programe dhe projekte të kërkimit shkencor.** Lidhja e marëveshjeve të bashkëpunimit me institucione analoge vendase dhe të huaja si dhe pjesëmarrja në programe të kërkimit shkencor, mobilitetit si dhe partneriteti në projekte ndërkombëtare me focus sigurimin e cilësisë;
- 7. Aksesi në informacion.** Krijimi dhe mirëmenaxhimi i sistemit të brendshëm të informacionit që mundësojnë administrimin e bazës së të dhënave si dhe akses të dedikuar në informacion në kohë reale si për personelin akademik ashtu edhe për studentët, në funksion të mbarëvajtjes dhe administrimit të procesit mësimor në këtë program studimi;
- 8. Lidhja me tregun e punës.** Krijimi i lidhjeve dhe bashkëveprimit me komunitetin e biznesit dhe tregun e punës nëpërmjet bashkëpunimit institucional si dhe krijimit të strukturave që ndihmojnë përshtatjen e kurrikulave me nevojat e tregut të punës;

**b. Pika të dobta:**

- 1. Fondi fizik i bibliotekës nuk disponon kapacitetet e duhura të literaturës bashkëkohore, veçanërisht asaj në gjuhën shqipe në mbështetje të programit të studimit;**



2. Raportimi i veprimtarisë finciare është paraqitur si një i tërë dhe nuk i referohet në mënyrë specifike zërave në shërbim të realizimit të programit të studimit Bachelor në "Juridik i Përgjithshëm";


#### **Rekomandime:**

1. Përmirësimi i kapaciteteve të bibliotekës nëpërmjet pasurimit të fondit fizik të saj me literaturë bashkëkohore si dhe ritja e ndërgjegjësimit të studentëve në raport me aksesin ndaj bibliotekës;
2. Realizimi veprimtarisë financiare dhe raportimi financiar të mundësojë pasqyrimin e të dhënave mbi shpërndarjen e burimeve financiare për secilin nga programet e studimit;

#### **Conclusions of the Evaluation of the First Cycle Study Program Bachelor in: "General Law"**

##### **a. Strengths and affirmations:**

1. **Program curriculum:** The curricular content of this study program enables students to equip themselves with the necessary theoretical knowledge in the legal field by harmonizing the basic knowledge of the fields of private and public law with specific and characteristic ones in accordance with the challenges and needs of the labor market;
2. **Commitment of human resources:** Optimal commitment of human resources, both academic and administrative personnel, for the development of this program in accordance with its objectives;
3. **Recruitment and promotion of academic staff:** Approval of transparent procedures, based on the legal criteria of staff recruitment, as well as promotion and performance evaluation of academic staff;
4. **Quality evaluation and monitoring:** Institutionalization of the internal quality system, through the use of methodologies and measuring instruments for evaluating the progress and quality of the program, as well as establishing permanent mechanisms and functional assessment and quality assurance, as well as continuous quality improvement strategies in the institution;
5. **Student participation in quality assessment:** Involvement of students in the quality assessment process through instruments that enable them to express their opinion as well as representation in the selected structures responsible for quality supervision and assessment;
6. **Participation in scientific research programs and projects:** Cooperation agreements with similar local and foreign institutions as well as participation in scientific research programs, mobility and partnership in international projects with focus on quality assurance;
7. **Access to information:** Creation and maintenance of the internal information system that enables the administration of the database as well as dedicated access to information in real time for both academic staff and students, in function of the smooth running and administration of the process teaching in this study program;





8. **Connection with the labor market:** Creating connections and interaction with the business community and the labor market through institutional cooperation and the creation of structures that help adapt the curricula to the needs of the labor market;

**b. Weaknesses:**

1. The physical fund of the library does not have an adequate capacity of contemporary literature, especially that in the Albanian language in support of the study program;
2. The financial activity reporting is presented as a whole and does not specifically refer to the items in service of the realization of this study program;

**Recommendations:**

1. Improving the capacities of the library through the enrichment of its physical fund with contemporary literature as well as increasing the awareness of students in relation to access to the library;
2. Realization of financial activity and financial reporting to enable the reflection of data on the distribution of financial resources for each of the study programs;

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X



<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				<b>X</b>
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE</b>				<b>X</b>
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

